




METODAT E EDUKIMIT PROFETIK

Osman Nuri TOPBASHI





Titulli origjinal: ONUN عĞİTİM LİSÂNI

Përktheu: Luan Afmataj

Redaktor: Zija Vukaj

Redaktor: Alban Kali

Design: Bledar Xama



PROGRESI sh.p.k. _____

Adresa: Sheshi "2 Prilli" / Rr: Studenti / Shkodër / Shqipëri

Mob: +355 67 340 6182

http: www.progresibotime.com

e-mail: botime@progresibotime.com

Adresa Kosovë: Rr: Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin / Prizren

Tel: +381 29 222 795


Fax: +381 29 222 797

e-mail: kosova@progresibotime.com

Adresa Maqedoni: Rr: Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25 / Shkup

Tel: +398 71 956 271

e-mail: maqedoni@progresibotime.com



METODAT E EDUKIMIT PROFETIK

Osman Nuri TOPBASHI





PARATHËNIE

Allahu i Lartësuar i dhuroi Pejgamberit të fundit, Muhamedit ﷺ, “kelimetullah” fjalën e Tij, si mrekullinë më të madhe.

Kurani Famëlartë, me gjuhën e tij të pastër e poetike, i ka sfiduar të gjithë shkrimtarët dhe poetët, madje do të vazhdojë t'i sfidojë ata deri në Ditën e Kiametit. Edhe poetët më të zotë kanë mbetur të pafuqishëm përballë kësaj Fjale Hyjnore.

Allahu ﷻ, për ta përforcuar rrugëtimin e Pejgamberit ﷺ, i ka dhuruar edhe një cilësi të quajtur “Xheva-miul-kelim”, që do të thotë, aftësia për të shprehur shumë kuptime me pak fjalë.

Profeti ﷺ, i edukoi shokët e tij me fjalën e Zotit, me bisedat e mbushura me mirësi, begati si dhe me gjuhën e tij të ëmbël.

Sepse;



Feja mësohet me fjalë; me fjalë bëhet tërheqëse; fjala bëhet motivuesja e një zemre të gjallë.

Zoti i Lartmadhëruar dëshiron nga ne një gjuhë kuranore. Shembulli më i bukur dhe më i qartë i kësaj gjuhe është ajo e Pejgamberit ﷺ, e shprehur për ymetin e tij. Është ajo gjuhë e shpalosur në atë që quhet ilaçi i jetës, në hadithet e tij. Fjala e tij është fjala më e bukur, më e butë dhe më e dashur, që përcjell qetësi në brendësi të zemrave.

Ky libër i vogël në dorën tuaj, është shkruar si përmbledhje e mrekullueshme e cilësive morale dhe edukuese që fjala apo gjuha e tij zotëronte.

Nuk duhet harruar se është detyrë e secilit nga ne që të përvetësojë, të zbatojë gjuhën edukuese të Pejgamberit ﷺ dhe metodat praktike që ai ndiqte.

E lus Zotin e Gjithësisë që kjo vepër e thjeshtë, të shërbejë sadopak në realizimin e kësaj detyre.

Suksesi i përket vetëm Allahut!

Osman Nûri TOPBASH
Stamboll, Mars 2015





Gjuha e Tij

METODAT E EDUKIMIT PROFETIK



*"Kush i beson Allahut dhe Ditës së Fundit
le të flasë mirë ose le të heshtë"*

(Buhari, Edeb 31, 85, Rikak 23)



GJUHA E TIJ EDUKUESE

RËNDËSIA E MORALIT TË FJALËS

Kapitali më i çmueshëm i arsimit dhe edukimit është fjala.

Një besimtar, moralin e fjalës e mëson nga Kurani i madhërueshëm.

Kurani për besimtarët, në aspektin e kuptimit gjuhësor, ashtu sikurse në çdo aspekt tjetër të jetës, është udhërrëfyesi më i mirë. Përmes këtij libri të shenjtë ne mësojmë gjuhën kuranore.

Veçoria e parë e domosdoshme e fjalës së moralshme është vërtetësia e saj. Sadoqë fjalët tona të jenë të buta, të ëmbla, ndikuese, nëse gjuha jonë nuk shpreh një të drejtë ose nuk flet të vërtetën, ajo është e kotë dhe e pa vlerë. Allahu i Lartmadhëruar thotë:



“(Besimtarët janë ata) të cilët shmangen nga fjalët e kota.” (Mu'minun, 3)

Për këtë arsye, në aspektin e pëgjithshëm të urdhrit të Zotit ﷻ, në besimin e myslimanit qëndron fjala e drejtë. E thënë ndryshe;

“قَوْلًا سَدِيدًا / KAVLEN SEDIDA”

“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe thoni vetëm të vërtetën.” (Ahzab, 70)

Fjala e drejtë është çelësi i mbarësisë dhe i lumturisë, si në këtë botë ashtu edhe në Ahiret. Drejtësia është cilësia më e rëndësishme e fjalës, por jo cilësia e saj e vetme. Gjithashtu forma dhe vendi i fjalës së drejtë përbëjnë një rëndësi mjaft të madhe.

Rrugët për t'ia paraqitur të vërtetat më të hidhura, paralajmërimet më serioze apo qortimet më të rënda një zemre njerëzore, kalojnë përmes fjalëve të duhura dhe shprehjeve më të goditura. Në aspektin e përgjithshëm kjo është një “fjalë e bukur”.

Ja si shprehet në Kuran:

“وَقُولُوا لِلنَّاسِ حُسْنًا / KAVLI AHSEN”

وَقُلْ لِعِبَادِي يَقُولُوا الَّتِي هِيَ أَحْسَنُ

“dhe thoni njerëzve fjalë të mira.” (Bekare, 83)

“(besimtarët janë ata) të cilët shmangen nga fjalët e kota.”

(Mu'minun, 3)





“Thuaju, robërve të Mi, që të flasin atë që është më e mira.” (Isra, 53)

Po ashtu, në ajetin e Kuranit thuhet:

“Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur...” (Nahl, 125)

Prej gojës së besimtarit duhet të rrjedhë gjithmonë mëshirë. Tek asnjëri prej pejgamberëve të Zotit nuk gjendet një fjalor i vrazhdë në bisedë me njerëzit. Ata në misionin e tyre hyjnor, gjithmonë e kanë paraqitur fenë me shprehjet më të bukura dhe kanë qetësuar zemrat. Po ashtu, “Evlijaullah” (njerëzit e dashur të Zotit), të cilët ndiqnin në çdo hap rrugën e profetëve, nuk kanë përdorur kurrë fjalor të vrazhdë.

Përveç dy cilësive të etikës së fjalës, drejtësisë dhe bukurisë, të shprehura në aspektin e përgjithshëm, Kurani i Madhërishëm përmend edhe disa cilësi të tjera për persona të veçantë.

Njëra nga këto cilësi të veçanta është paraqitja e të vërtetave me butësi në varësi të personave me natyrë të ashpër, agresivë dhe arrogante, me qëllim që t’u zbutet zemra. Domethënë;

“قَوْلًا لِّينًا” / KAVLI LEJ-JIN

“Flitini atij (Faraonit) fjalë të buta, se ndoshta kujtohet a frikësohet!” (Taha, 44)

“dhe, për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë).”

(Kaf, 18)





Asnjë përrua apo lumë nuk ngjitet dot në mal. Nëse ndonjëri prej tyre dëshiron ta kapërcejë malin, atëherë atij do t'i duhet të kalojë anash atij. Në këtë mënyrë gjatësia e rrugës së dëshiruar zgjatet, por arrihet dëshira dhe qëllimi i caktuar.

Fjala e butë (kavli lej-jin) në edukimin fetar, përbëhet nga paraqitja e të vërtetës me një metodë të qetë dhe të butë, duke u distancuar nga format ofenduese, të cilat shpesh na largojnë nga qëllimi pozitiv e mirëkuptimi dhe orientojnë drejt debateve.

Allahu ﷻ, thotë kështu duke iu drejtuar Pejgamberit të Tij, ﷺ:

“Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoji falje Allahut për ata dhe këshillohu me ta për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai.” (Ali Imran, 159)

Ky është një ajet jashtëzakonisht i rëndësishëm, i cili paraqet pavlefshmërinë e vrazhdësisë dhe nga ana tjetër, burimin e mirësive për shkak të butësisë në marrëdhëniet mes mësuesit dhe nxënësit.

Ajo që kërkohet në edukim është fjala e butë por me ndikim të fortë.... Kështu thuhet;

*“Kush i beson Allahut dhe Ditës së Fundit
le të flasë mirë, ose le të heshtë.”*

(Buhari, Edeb 31, 85, Rikak 23.)





“قَوْلًا بَلِيغًا” / KAVLI BELIG

“Këta janë ata për të cilët Allahu e di se ç’kanë në zemrat e tyre. Largohu prej tyre, këshilloji dhe thuaj fjalë që i prekin në zemër.” (Nisa, 63)

Zoti i Lartmadhëruar kërkon prej robërve të Tij një besë e cila e detyron besimtarin të flasë me prindërit me fjalë të buta dhe të ëmbla.

Domethënë;

“قَوْلًا كَرِيمًا” / KAVLI KERIM

“Mos u thuaj atyre as “uh!”, mos i kundërshto, por drejtoju atyre me fjalë respekti..” (Isra, 23)

Në vazhdimin e ajetit flitet për mëshirën që prindërit tregojnë për edukimin e fëmijëve të tyre. Ajo që duhet të kuptohet është se:

Prindërit duhet t’i rrisin fëmijët me fjalë të ngrohta dhe të dashura; ndërsa fëmijët duhet të flasin me ta me fjalë të bukura, të ëmbla, të çmuara, në mënyrë që në themelet e familjes të mbizotërojnë gjithmonë respekti, dashuria dhe begatia.

Ashtu sikurse me prindërit, Allahu ﷻ, urdhëron të përdoret një gjuhë e tillë për të fituar edhe zemrën e ndjeshme të nevojtarëve. Domethënë;

“Thuaju, robërve të Mi të flasin atë që është më e mira.

(Isra, 53)





“قَوْلًا مِّنْسُورًا / KAVLI MEJSURA”

“Por, nëse shmangesh nga ata (kur nuk ke asgjë për të dhënë), duke shpresuar në mëshirën e Zotit tënd, atëherë thuaju atyre fjalë të butë.” (Isra, 28)

Pejgamberi ﷺ, ishte i urdhëruar që t’u fliste nevojtarëve myslimanë me fjalë të buta. Në të njejtën kohë ai ishte edhe mësuesi i tyre. Ky ajet u jep një mesazh mësuesve. Ata duhet të shqetësohen për problemet materiale apo shpirtërore të nxënësve, duhet t’u japin rëndësi atyre dhe nuk duhet kurrsesi t’ua kthejnë shpinën qoftë edhe në pamundësi për t’i ndihmuar.

Edukata në komunikim ka edhe një veçori tjetër e cila konsiston në shprehjen e fjalës së bukur në vendin dhe kohën e duhur. Domethënë;

“قَوْلًا مَّعْرُوفًا / KAVLI MA'RUF”

“dhe u thoni atyre fjalë të mira.” (Nisa, 5)

“Ec me kujdes e i përmbajtur dhe fol me zë të ulët; se zëri më i vrazhdë është zëri i gomarit!” (Llukman, 19)

Të gjitha këto janë forma të gjuhës së kuranit të cilat çdo besimtar duhet t’i mësojë.

Një besimtar duhet të dijë cilën fjalë të thotë dhe ku ta thotë atë.

Ahmed Havari:

*“Nëse përtyp një kafshatë të panevojshme,
prej andej do të dalë një fjalë
e panevojshme.”*





Në lidhje me këtë, Ebu Bekri رضي الله عنه, në një këshillë thotë:

“Mos harro çfarë ke thënë, kujt ia ke thënë dhe ku e ke thënë.”

Sepse ajo çka del nga goja, regjistrohet me anë të kameras hyjnore. Dhe Ditën e Gjykimit secili prej nesh do ta shikojë vetveten në atë regjistrim.

Në ajetin e Kuranit thuhet kështu:

“dhe, për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë).” (Kaf, 18)

Për shkak të kësaj të vërtete, Pejgamberi ﷺ, na paralajmëron dhe thotë:

“Kush i beson Allahut dhe Ditës së Fundit le të flasë mirë, ose le të heshtë.” (Buhari, Edeb 31, 85, Rikak, 23.)

Gjithashtu Pejgamberi ﷺ, thotë:

“Mos thuaj një fjalë për të cilën detyrohesh të kërkosht ndjesë.” (Ibn Maxhe, Zuhd, 15)

Nëse fjala del nga zemra, ajo depërton në zemër.

Por nëse del nga gjuha, ajo nuk e kalon veshin, pengohet aty dhe nuk zbret në zemër.

Një ditë i Dërguari i Allahut ﷺ, i rrethuar nga pyetjet e Muadh ibn Xhebelit رضي الله عنه, i drejtohet atij me disa udhëzime dhe e këshillon që të bëjë më shumë punë

“Mos e thuaj një fjalë për të cilën do të detyrohesh të kërkosht falje.”

(Ibn Maxhe, Zuhd, 15.)





të hajrit. Më pas, duke treguar me gisht gjuhën e tij të bekuar, urdhëron dhe thotë:

“Njeriu duhet të flasë gjithmonë rreth temave të dobishme, në të kundërt duhet të heshtë.” Muadhi e pyeti:

“A do të japim llogari për bisedat tona?”

Atëherë i Dërguari i Allahut ﷺ ia preku gjurin dhe tha këto fjalë:

“Allahu të dhëntë të mirën o Muadh! Çka i zvarrit njerëzit me fytyrë përtokë në Xhehenem përveçse fjalëve që gjuhët e tyre thonë? Kush i beson Allahut dhe Ditës së Fundit le të flasë fjalë të mira, ose le të heshtë, mos të thotë fjalë të dëmshme! Duke thënë fjalë të hajrit dilni të fituar; duke u larguar nga fjalët e dëmshme e gjeni qetësinë dhe rehatinë.” (Hakim, IV, 319/7774.)

Në lidhje me rëndësinë që i duhet kushtuar fjalës, hadithi i mëposhtëm është mjaft i rëndësishëm:

“Njeriu thotë një fjalë prej së cilës Allahu është i kënaqur me të, por nuk i shkon mendja që do të fitojë kënaqësinë e Allahut. Por Allahu ﷻ, për shkak të asaj fjale është i kënaqur me atë person deri në Ditën e Kiametit, (ditën) kur do ta takojë Allahun.

Po ashtu, një njeri e thotë një fjalë prej së cilës zemërohet Allahu, por nuk e mendon se dënimi i Allahut do ta gjejë atë një ditë. Porse Allahu, për shkak të asaj fjale, atë

*Një nga synimet më të mëdha të edukimit
duhet të jetë edukimi i njeriut që të mos thotë gënjeshtër.
Për këtë gjë, pikësëpari është e domosdoshme
që edukatori të qëndrojë jashtëzakonisht
larg çdo lloj gënjeshtre.*





person e dënon deri në Ditën e Kiametit, (ditën) kur do të dalë përpara Allahut.” (Tirmidhi, Zuhd, 12; Ibn Maxhe, Fiten, 12)

Me pak fjalë; mësueset dhe mësuesit tanë janë të detyruar që ta mësojnë dhe ta përvetësojnë shumë mirë gjuhën e dashur të kuranit dhe domethëniet e saj edukative. Ata gjithashtu duhet të jenë të motivuar vazhdimisht për edukimin e nxënësve me këto parime të larta.

E VËRTETA

Pejgamberi ﷺ, ishte dërguar si plotësues i moralit të bukur. Ai ishte i përpiktë me shokët e tij përsa i përket edukatës dhe moralit. Nëna e besimtarëve, Aishja رضي الله عنها, na e tregon kështu me shembuj ndjeshmërinë e tij për këtë çështje:

“Nuk kishte ndonjë sjellje më të keqe dhe më të shëmtuar për të Dërguarin e Allahut sesa gënjeshtria. Nëse dëgjonte nga ndonjëri prej shokëve të tij qoftë edhe një gënjeshtër të vogël, i qëndronte larg dhe nuk dëshironte të takoj me të derisa gënjeshtari të pendohej (të bënte teube).” (Ibn Sa‘d, I, 378.)

Nufej bin Harith رضي الله عنه, shprehet kështu:

Një ditë i Dërguari i Allahut ﷺ, pyeti tri herë;

“A t’ju them se cili është njëri prej mëkateve më të mëdha?”

“Po, o i Dërguari i Zotit”, iu përgjigjëm ne.

“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: “Paqe qoftë!”

(Furkan, 63)





Atëherë Ai ﷺ, tha:

“Shirku ndaj Allahut, mosbindja ndaj prindërve!” pasi tha këto fjalë, u ngrit nga vendi ku ishte mbështetur, qëndroi drejt dhe tha: ‘Dëgjoni me kujdes, gjithashtu të gënjeshtër dhe të dëshmosh në favor të gënjeshtarëve!’”

Këto fjalë i përsëriti aq shumë saqë ne, ngaqë nuk dëshironim që të shqetësohej më tepër, pëshpëritnim me vete; “Ah sikur të qetësohej dhe të mos lodhej më shumë.” (Buhari, Shehadat 10, Edeb 6, Isti’zan 35, Istitabe 1; Muslim, Iman 143.)

Një ditë i Dërguari i Allahut ﷺ, urdhëroi dhe tha:

“Allahu ﷻ, ia bën haram Xhenetin dhe e dërgon në Xhehenem atë person që ia merr të drejtën myslimanit duke u betuar në gënjeshtëri.”

“Edhe sikur të jetë diçka e vogël o i Dërguari i Allahut?” e pyetën.

I Dërguari i Allahut ﷺ, u pëgjigj:

“Edhe sikur të jetë sa një misvak!” dhe këto fjalë i përsëriti tri herë. (Muslim, Iman, 218; Muvatta; Akdije, 11.)

Këto hadithe na tregojnë se një besimtar nuk duhet kurrsesi të thotë gënjeshtër apo të shkelë të drejtat e vëllait të tij mysliman.

Është gënjeshtër që e shpie njeriun drejt mohimit, ndërsa mohimi e dërgon atë në Xhehenem. Njeriu vazhdon të thotë gënjeshtër, derisa të shkruhet tek Allahu prej gënjeshtarëve. (Buhari, Edeb, 69; Muslim, Birr, 103-105.)

*Mevlana thotë:
“Përballë injorantëve
hesht si një libër.”*





Përveç kësaj, njeriu duhet t'u kushtojë rëndësi edhe kafshatave që shkojnë në barkun e tij, nëse ato janë hallall apo haram.

Është një e vërtetë e pamohueshme që kafshata e cila futet në gojë, kur është hallall ndikon tek njeriu në mënyrë pozitive, ndërsa kur është haram ndikon negativisht.

Në lidhje me këtë çështje Ahmed Havari thotë kështu:

“Nëse përtyp një kafshatë të panevojshme, prej andej do të dalë një fjalë e panevojshme” (Feriduddin Attar, Tezkiretu'l- Evliya, I, 341.)

Një nga synimet më kryesore të edukimit duhet të jetë përgatitja e një njeriu me karakter që nuk gënjen.

Për ta realizuar këtë gjë, pikësëpari edukatori duhet të qëndrojë larg çdo lloj gënjeshtre.

Imani (besimi) dhe gënjeshtra nuk mund të qëndrojnë dot së bashku. Prandaj edhe në edukimin fetar gënjeshtra nuk ka vend. Nëse ka, atëherë aty nuk flitet më për edukim.

TOLERANCA

Periudha njëzet e tre vjeçare e profecisë së Pejgamberit ﷺ, ka luajtur rolin më të rëndësishëm në shpjegimin dhe komentimin e Kuranit të Madhërishëm.

*“Ruajuni grindjeve!
Sepse ato janë si koha e injorancës për dijetarin.
Djalli dëshiron që ta devijojë dijetarin me to.”*

(Darimi, Mukaddime, 35/402.)





Profeti ﷺ gjithë jetën e tij të bekuar e ka kaluar vetëm duke përhapur Islamin dhe nuk është bërë kurrë pjesë e debateve apo grindjeve.

Sepse Allahu ﷻ thotë:

“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin me modesti nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: “Paqe qoftë!” (Furkan, 63) Ashtu sikurse paraqitet në ajetin e Kuranit, njëra prej cilësive të robërve të singertë të Allahut është se ata nuk grinden me asnjëri dhe nuk bëhen pjesë e debateve dhe grindjeve.

Ndërsa Mevlana e shprehte kështu këtë virtyt:

“Është e domosdoshme që përballë të paditurve të jesh si një libër i heshtur.”

Sipas transmetimit të Jahja bin Ebi Kethir-it, Sulejmani عليه السلام, i jepte këto këshilla djalit të tij:

“Largohu prej diskutimit dhe grindjes! Sepse dobia e tyre është e vogël. (Mbi të gjitha) ato provokojnë dhe nxisin armiqësi mes vëllezërve.” (Darimi, Mukaddime, 29/309)

Sjellja e një besimtari është delikate, fjaë e ëmbël dhe heshtja e hijshme. Njeriu kur është i zemëruar nuk merr dot vendime të drejta. Shpeshherë merr vendime të gabuara.

Muslim bin Jesar رحمه الله, e shpjegon kështu realitetin e mësipërm:

*Edukatorët duhet të komunikojnë
me nxënësit me zemërbutësi e mirësjellje,
si dhe nuk duhet të lejojnë që në mesin
e tyre të hyjë ndonjë grindje.*





“Ruajuni prej grindjeve, sepse ato janë si koha e paditurisë për dijetarin. Djalli dëshiron që ta devijojë dijetarin me to.” (Darimi, Mukaddime, 35/402.)

Po ashtu, sipas një mesazhi të Shehr ibn Havsheb-it رحمته الله, thuhet:

“Sipas asaj që më ka ardhur mua, profeti Llukman عليه السلام, e këshillonte kështu djalin e tij:

“Biri im i dashur! Mos e mëso ilmin (diturinë) për t’u krekosur me dijetarët, për t’u grindur me injorantët apo për t’u dukur nëpër mexhlise (tubime).” (Darimi, Mukaddime, 34/383.)

Këshillat e profetit Llukman عليه السلام, njoftojnë veçanërisht për kurthet të cilat shejtani i mallkuar i ngre përballë rrugëtarëve të dijes dhe edukimit. Ata që e përdorin diturinë si mjet për të debatuar dhe për t’u grindur me të tjerët, nuk marrin as edhe një dobi prej saj.

Edukatorët duhet të komunikojnë me nxënësit me zemërbutësi dhe mirësjellje. Nuk duhet të lejojnë depërtimin në mesin e tyre të grindjeve dhe debateve të panevojshme.

RESPEKTI

Gjuha dhe fjalët duhet të jenë burime urtësie prej të cilave burojnë të vërtetat hyjnore dhe bukuritë e pashtershme shpirtërore. Sekret i suksesit gjendet tek urtësia.

Ebu Bekri رضي الله عنه:

*“Mos harro çfarë ke thënë, kujt ia ke thënë
dhe ku e ke thënë.”*





Gjuha e ashpër e thyen zemrën dhe i largon njerëzit nga tema e bisedës.

Zoti i Lartmadhëruar urdhëron:

“Fol me zë të ulët; se zëri më i vrazhdë është zëri i gomarit!”

Domethënë, zëri yt mos t'i ngjajë zërit të gomarit! Të gjithë kanë dëshirë të dëgjojnë tingujt e ëmbël të një bilbili. Askush nuk dëshiron të dëgjojë zërin shurdhues të një gomari. Kjo do të thotë se zëri i njeriut nuk duhet t'i ngjajë zërit të gomarit. Ai duhet të jetë i butë dhe i ëmbël. Gjuha duhet të shpalosë shpirtin e të vërtetave.

I Dërguari i Allahut ﷺ, shkon njëherë për të vizituar Ummu's-Sâib-en dhe e pyet:

“Çfarë ke, o Ummu's-Sâib-e, që po dridhesh?”

“Më ka kapur Humma (temperaturë e lartë), E shoftë Zoti këtë sëmundje!” u përgjigj ajo.

Atëherë Pejgamberi ﷺ, tha:

“Mos e ofendo Humma-n! S'ka dyshim se ajo i pas-tron gabimet e birit të Ademit, ashtu sikurse shakulli pas-tron njollat e hekurit.” (Muslim, Birr, 53.)

Besimtari nuk e ndot gjuhën me fjalë të këqija, nuk ofendon njeri dhe nuk ofendohet prej dikujt. Zemra e tij duhet ta fitojë këtë gradë.

*Gjuha dhe fjalët, duhet të jenë burime
urtësie përmes të cilave shpalosen të vërtetat hyjnore
dhe bukuritë e pashtershme shpirtërore.
Sekreti i suksesit ndodhet në urtësi.*





Në qoftë se personi me të cilin po dialogojmë sillet me arrogancë dhe ne gabimisht i përgjigjemi me të njëjtën formë, atëherë duhet të na vijë në mendje fjalët e Aliut عليه السلام:

“Mos mendo të replikosh me njerëz që flasin fjalë të ulta sepse ai person kushedi se sa fjalë të tjera të ulta ka në mendje, replikës tënde përsëri do t'i përgjigjet me të njëjtat fjalë.”

Edukimi realizohet me fjalë të ndritura. Sjelljet dhe fjalët e pahijshme nuk duhet të kenë kurrë vend në institucionet e edukimit.

NJË HYRJJE E SJELLSHME NË TEMAT KU SYNOHET TË ARRIHET GJATË PROCESIT EDUKATIV

Turpi, si pjesë ndjesie njerëzore, është një mburojë shpirtërore që na mbron nga çdo e keqe. Por ndjenja e turpit nuk duhet të bëhet pengesë për ata që dëshirojnë të mësojnë dituritë të cilat i kanë farz (detyrim). Domethënë, besimtari për shkak të turpit, nuk duhet të hezitojë të mësojë, të marrë njohuritë dhe edukimin e domosdoshëm.

Në ajetin e Kuranit thuhet:

“Allahu nuk turpërohet që t’jua thotë të vërtetën.”

(Ahzab, 53)

Besimtari nuk e ndot gjuhën me fjalë të këqija. Nuk ofendon njeri dhe nuk ofendohet prej dikujt. Domethënë, zemra e tij duhet ta fitojë këtë gradë.





Kur Pejgamberi ﷺ, dëshironte të fliste në lidhje me tema të turpshme, lexonte në fillim këtë ajet. Po ashtu, shokët e tij të nderuar (as'habët) kur dëshironin ta pyesnin për tema të turpshme, sikurse janë rastet e marrjes së gusulit (pastrimi i trupit pas raporteve seksuale), në fillim përsëritnin këtë ajet dhe më pas i bënë pyetje të Dërguarit të Allahut ﷺ.

Aishja رضي الله عنها, tregon se Pejgamberi ﷺ, ka thënë kështu në lidhje me gratë e ensarëve (medinasve):

“Sa gra të mira janë gratë e ensarëve. Turpi nuk i ndalon ato për t’u thelluar në mësimin e çështjeve të fesë.” (Muslim, Hajz, 61.)

Edhe edukatorit, në rastet kur i duhet të shpjegojë ndonjë temë që shkakton turp, në fillim bën një hyrje të shkurtër, sikurse vepronin sahabët e nderuar, duke u shprehur se i duhet të jetë i hapur në fjalë për shkak të rëndësisë së temës ose me qëllim që tema të kuptohet me lehtë, pastaj e shpjegon atë në një formë të kuptueshme për të gjithë.

Për shembull Pejgamberi ﷺ, njëherë e kishte nisur fjalën duke thënë:

“Është e vërtetë se unë jam në gradën e baballarëve tuaj; ju edukoj, ju këshilloj dhe ju mësoj njohuritë për të cilat keni nevojë...” (Ebu Davud, Taharet, 4.) Pas kësaj hyrjeje të shkurtër, u shpjegoi me detaje shokëve të tij rregullat e hyrje-daljeve nga tualeti.

*“Flitini atij (Faraonit) fjalë të buta,
se ndoshta kujtohet a frikësohet!”*

(Taha, 44)





Nga ana tjetër, në rastet kur duhen diskutuar tema të cilat prekin çështje private të njerëzve, atëherë shpjegohen me fjalë të kujdesshme, por me kusht që tema të mos mbetet e mbyllur dhe e pakuptueshme. Është më e përshtatshme që temat në lidhje me meshkujt të trajtohen nga meshkujt, ndërsa ato në lidhje me femrat të trajtohen nga femrat.

Për shembull gratë, jo gjithmonë kanë pyetur të qeta Pejgamberin ﷺ, në lidhje me çështjet e turpshme. Për këtë arsye gratë e sahabëve, në lidhje me shume çështje intime, kanë përdorur si ndërmjetëse gratë e Pejgamberit ﷺ, për të mësuar zgjidhjen e tyre.

Ndërsa në rastet kur e kanë pyetur drejtpërsëdrejti Pejgamberin ﷺ, atëherë Ai ﷺ, për shkak të ndrojtjes dhe ndershmërisë së thellë, është përgjigjur duke zgjedhur fjalë të kujdesshme dhe më pas shpjegimin më të hollësishëm e kanë marrë përsëri prej grave të tij. (Buhari, Hajz, 13, 14; Muslim, Hajz, 60; Ebu Davud, Taharet, 107; Darimi, Vudu, 75; Nesai, Gusl, 21; Muvatta, Taharet, 105.)

Një aspekt tjetër i kësaj metode është domosdoshmëria e dhënjes së përgjigjes në lidhje me një temë intime pa e përfshirë vetë pyetësin në këtë temë.

Është më e drejtë që të përdoren për shembull shprehjet: “Nëse dikujt nga ju i ndodh... Njerëzit duhet të sillen kështu në rast se...”

Aliu ﷺ:

“Mos mendo të replikosh me njerëz që flasin fjalë të ulta sepse ai person kushedi se sa fjalë të tjera të ulta ka në mendje, replikës tënde përsëri do t’i përgjigjet me të njëjtat fjalë.”





Njëherë, ndërsa Pjegamberi ﷺ, po rrinte së bashku me shokët e tij, dikujt brenda xhematit i shpëton një gaz. Por nuk u kuptua se cili e bëri. Pasi hëngrën ushqimet e gatuara me mish deveje, erdhi koha e namazit. Duke e ditur se sahabiu të cilit i ishte prishur abdesti do të ngrihej për të marrë abdest, i Dërguari i Allahut ﷺ, me qëllim që të mos zbulohet kush kishte qenë sahabi, u tha të pranishëmve:

“Le të marrin abdest të gjithë ata që kanë ngrënë mish deveje.” Në këtë mënyrë e mbajti të fshehtë personin i cili e prishi abdestin dhe nuk e turpëroi përpara njerëzve.

I Dërguari i Allahut ﷺ edhe nëse e dinte se kush është fajtori në mes të njerëzve, për të mos e ofenduar atë, e fshihte gabimin pa u kuptuar, por nga ana tjetër i edukonte njerëzit që të kishin kujdes dhe të mos kryenin veprime të tilla.

Nganjëherë për t’u dhënë të kuptonin të pranishmëve gabimin e bërë, përdorte shprehjen “galat-i ru’jeh” (shikim i gabuar):

“Çfarë po më ndodh mua, që ju shoh të veproni kështu.” (Buhari, Menakib, 25; Muslim, Salat, 119.)

Po ashtu, kur i Dërguari i Allahut ﷺ, dëgjonte për ndonjë fjalë negative të dikujt, nuk thoshte:

“Përse filani ka thënë kështu?”, por thoshte:

“Çfarë po ndodh me njerëzit që (po dëgjojmë të) thonë kështu?” (Ebu Davud, Edeb, 5/4788.)

*Unë ju urdhëroj juve pesë gjëra:
Allahu ato m’i urdhëroi mua.
Dëgjimin, bindjen, xhihadin,
hixhretin dhe xhematin”*

(Tirmidhi, Edeb, 78/2863; Ahmed, IV, 130, 202.)





METODAT E SHPJEGIMIT

TRANSMETIMI I NGJARJEVE DHE NDODHIVE NË LIDHJE ME NJERËZIT MË PËRPARA

Gjatë periudhës së vuajtjeve në Mekë, i Dërguari i Allahut ﷺ, përdorte edhe këtë metodë për t'i thirrur njerëzit në Islam. Gjatë atyre ditëve i Dërguari i Allahut ﷺ, ulej në një mexhlis, i thirrte të pranishmit në besimin e Allahut, u lexonte Kuran dhe i motivonte ata duke u treguar mbi ndodhitë dhe vuajtjet e mëdha që kishin përjetuar popujt e mëparshëm. (Ibn Hisham, Siretu'n-Nebi, I, 381.)

Shpjegimi i temave me pjesë historike apo ngjarje të ndodhura më parë, lehtëson tregimin dhe gjithashtu përshejton edhe kuptimin e tyre. Sepse shembuj të tillë e hapin temën, zhvillojnë imagjinatën dhe hyjnë më kollaj në mendjen dhe në zemrën e dëgjuesve. Po ashtu, duke i dhuruar rrjedhshmëri formës së tregimit apo shkrimit, lehtësojnë edhe më shumë dëgjimin dhe leximin. Mevlana, Shejh Sadi dhe figura të tjera të ngjashme, i kanë shkruar veprat e tyre duke përfituar më së shumti prej kësaj metode.

Në këtë mënyrë, brenda tregimit u jepet lexuesve mesazhi i dëshiruar në formën më të bukur, ndërsa dëgjuesit edukohen lehtësisht dhe pa u mërzhitur.

Nga ana tjetër, ngaqë ngjarjet dhe tregimet nuk

"...u thoni njerëzve fjalë të mira."

(Bekare, 83)





përmabajnë ndonjë urdhër apo ndalesë për dëgjuesin, kjo metodë tingullon më ëmbël në vesh dhe në zemër dhe i nxit ata të përpiqen dhe të motivohen më shumë.

Atëherë kur njeriu mendon se tregimi nuk po i bën përshtypje, në një moment e gjen veten e tij brenda ngjarjes. Edhe studimet në lidhje me këtë temë tregojnë se rrëfimi posedon një forcë ndikuese jashtë ndërgjegjes së njeriut.

I Dërguari i Allahut ﷺ, e ka shpjeguar prishjen e një populli, i cili meriton dënimin e Zotit, me një shembull të Bijëve të Izraelit, të cilët si fillim e braktisën detyrën e thirrjes dhe këshillimit në fenë për të cilën ishin urdhëruar:

“Prishja e parë në mes të Bijëve të Izraelit ka filluar kështu. Një person, kur shikonte dikë duke bërë një të keqe e kritikonte duke i thënë:

“Shiko miku im! Kije frikë Allahun dhe hiq dorë nga kjo që bërë! Sepse kjo nuk është hallall për ty”. Ditën tjetër, me qëllim që të ulej pranë tij dhe të hanin e pinin së bashku, nuk e këshillonte më. Ja pra, atëherë Allahu i Lartësuar i bëri zemrat e tyre të ngjashme me njëra-tjetrën.”

Pastaj i Dërguari i Allahut ﷺ, lexoi këto ajete të Kuranit:

“Ata izraelitë që ishin mohues, u mallkuan me gjuhën e Dautit dhe të Isait, të birit të Merjemes, për shkak se kundërshtonin, shkelnin çdo kufi dhe nuk e

Pejgamberi ynë i dashur ﷺ, ka thënë:

“Kush kujdeset për jetimin do të jetë me mua në Xhenet si këta dy gishta” dhe bashkoi dy gishtat e dorës. (Buhari, Edeb, 24.)





ndalonin njëri-tjetrin të bënin vepra të këqija. Eh, sa të shëmtuara ishin veprat që bënin ata! Ti e sheh se shumë prej tyre miqësohen me jobesimtarët. Me të vërtetë, e keqe është ajo që i përgatisin ata vetes: që Allahu të zemërohet me ta dhe të mbesin në dënim përjetësisht. Sikur ata t'i besonin Allahut, të Dërguarit dhe asaj që i është shpallur atij, nuk do t'i merrnin jobesimtarët për miq. Por, shumica e tyre janë të pabindur.” (Maide, 78-81)

I plotësoi më pas i Dërguari i Allahu ﷺ, fjalët duke thënë:

“Edhe ju ose do të këshilloni njëri-tjetrin në punë të mira, do të ndaloni nga e keqja dhe do t'i qëndroni përballë padrejtësisë së tiranit, ose përndryshe Allahu i Lartësuar ua përngjan zemrat tuaja njëra-tjetrës dhe ju mallkon ashtu sikurse mallkoi Bijtë e Izraelit.” (Ebu Davud, Melahim, 17/4336; Tirmidhi, Tefsir, 5/6,7; Bejhaki, es-Sunenul-kubra, X, 93.)

Përsëri një ditë i Dërguari i Allahu ﷺ, u tregoi shokëve të tij historinë e njërit prej Bijëve të Izraelit. Ky person (i quajtur Shem'un-i Gazi) kishte luftuar me armë në dorë një mijë muaj në rrugën e Allahut, ndërsa netët i kishte kaluar me adhurim. Kur myslimanët dëgjuan për të, u mahnitën dhe e patën zili.

Atëherë Allahu ﷻ, për të treguar mirësinë dhe mëshirën që ka për ymetin e Muhamedit, zbriti suren Kadr:

“Ne e kemi zbritur (Kuranin) në Natën e Kadrit. E

*Ashtu sikurse uji shpon gurin e fortë
duke e goditur vazhdimisht në të njëjtën pikë,
edhe përqendrimi në punë të hajrit e bën çështjen
apo temën të ngulitet thellë në mendje
dhe në zemër.*





kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është nata e Kadrit? Nata e Kadrit është më e mirë se një mijë muaj. Engjëjt dhe Shpirti (Xhebraili), me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë, me të gjitha vendimet. Paqe është ajo deri në lindjen e agimit.” (Kadr, 1-5) (Shiko. Vahidi, fq. 486)

EDUKIMI ME ANË TË HUMORIT

Sado serioze qofshin temat në trajtim, nuk është domosdoshmërisht kusht që edukimi të bëhet përmes një fytyre të vrazhdë apo të shqetësuar. Herë-herë raportet në mes mësuesit dhe nxënësit kanë nevojë për buzëqeshje, dashuri dhe humor.

Edhe i Dërguari i Allahut ﷺ, herë pas here bënte shaka me shokët e tij të nderuar. Por gjithmonë shakatë që bënte kishin si synim përkëdheljen e shpirtit të personit në fjalë dhe kurrësi ato nuk synonin të preknin sedrën, karakterin apo ta përçmon atë. Gjithashtu, megjithëse ishte një shaka, ai nuk thoshte fjalë tjetër përveçse të vërtetës.

Kjo ngjarje përmban një shembull të metodës së veçantë të Pejgamberit të Zotit ﷺ, se si ai bënte shaka me njerëzit:

Një ditë vjen një person tek i Profeti ﷺ dhe i kërkon një kafshë për ta transportuar. Pejgamberi ﷺ, i thotë:

“Mirë atëherë, po të hipim në të voglin e një deveje femër.”

*Ajo që kërkohet në edukim
është fjala e butë, por me peshë...*





Personi i çuditur e pyet:

“O i Dërguari i Allahut! Çfarë ta bëj unë të voglin e një deveje femër, e si mund t’më mbajë ai mua!” Atëherë Pejgamberi ﷺ, ia ktheu me shaka:

“Si i vogli ashtu edhe i madhi i devesë, a nuk kanë lindur patjetër nga një deve femër?” (Tirmidhi, Birr, 57)

Duke u nisur nga kjo shaka, themi se personi i cili përballet me një fjalë, së pari duhet të dijë se çfarë kuptimi përmban ajo fjalë.

Kjo është me të vërtetë një çështje shumë e rëndësishme.

Ashtu sikurse duket në hadithin e mësipërm, nëse këndvështrimi ynë është i gabuar, ka të ngjarë që edhe domethënien e fjalës ta keqkuptojmë.

Së dyti, duhet që patjetër shakaja të jetë e vërtetë. Nuk duhet kurrsesi të përmbajë gënjeshtër. Sepse besimtarit nuk i shkon kurrë të gënjejë.

Njëherë vjen tek Pejgamberi ﷺ, një grua e moshuar dhe i thotë:

“O i Dërguari i Allahut! Lute Zotin që të futem në Xhenet!”

Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, ia kthen:

“Në Xhenet nuk hyjnë gratë e moshuara!” E moshuara nuk e kuptoi domethënien e vërtetë të fjalëve

“Besimtari i ngjan bletës. Ha atë që është e pastër, prodhon atë që është e pastër, qëndron në vende të pastra dhe aty ku qëndron as nuk e thyen, as nuk e dëmton.”

(Ahmed, II, 199; Hakim, I, 147)





dhe e mërzhitur filloi të qante. Atëherë Pejgamberi ﷺ, ia shpjegoi çështjen kështu:

“Gratë e moshuara nuk hyjnë të tilla në Xhenet, por (hyjnë duke qenë) të reja dhe të bukura. Andaj Allahu Teala urdhëron dhe thotë në Kuran; “të cilat Ne i kemi krijuar në një formë të veçantë (jo të lindura) dhe i kemi bërë ato virgjëresha, të dashura për bashkëshortët e tyre dhe moshatare me ta, për njerëzit e së djathtës.” (Vakia, 35-38) (Hejthemi, X, 419; Tirmidhi, Shemail, fq. 91-92.)

Shakatë e këndshme e qetësojnë njeriun dhe e lehtësojnë nga pesha e rëndë e shqetësimeve ditore. Gjithashtu, njeriu kur është i qeshur dhe i gëzuar, mëson më shumë dhe më lehtë sesa kur është i mërzhitur dhe me fytyrë të vrazhdë. Të qenit gjithmonë serioz, e lodh trurin dhe e ngadalëson zhvillimin e mendimeve. Shakatë e këndshme dhe të dobishme të përsëritura herë pas here, e rinovojnë njeriun dhe i sigurojnë një përqëndrim më të madh.

Kështu që gjatë procesit edukativ, mësuesit duhet të dinë të përdorin mirë dhe në formën e kërkuar humorin, me qëllimin e fitimit të vëmendjes së nxënësve, por pa dyshim duke mos i kaluar kufijtë e duhur.

SHPJEGIMI I NDARË NË DIKA

Truri i njeriu kupton dhe mëson më shpejt kur informacionet janë të kategorizuara. Pejgamberi ﷺ, duke

Edukatori nuk duhet të mjaftohet vetëm me përcjelljen e mesazhit në veshin e dëgjuesit; por duhet të dijë se si t’u flasë edhe syve me anë të lëvizjeve trupore, gjesteve dhe mimikës.





e përdorur këtë metodë, lehtësonte më shumë kuptimin dhe mësimin përmendsh nga ana e dëgjuesit të mesazhit të cilin dëshironte t'ia përcillte.

Për shembull, Pejgamberi ﷺ, kur po e këshillonte dikë i tha:

“Vlerësoji pesë gjëra përpara se të vijë pesë të tjera!

- *Rininë përpara pleqërisë;*
- *Shëndetin përpara sëmundjes;*
- *Pasurinë përpara varfërisë;*
- *Kohën e lirë përpara se të jesh i zënë;*
- *Jetën përpara se të të vijë vdekja.”* (Hakim, IV, 341/7846.)

Nëse nuk veprohet sipas përmbajtjes së hadithit, përfundimi i pritshëm shpjegohet në një tjetër hadith me pika të shkurtra:

“Asnjë njeri nuk lëviz nga vendi i tij Ditën e Kiametit derisa të japë llogari për;

- *Jetën, ku e ka harxhuar;*
- *Diturinë, si e ka shfrytëzuar;*
- *Pasurinë, ku e ka fituar dhe si e ka harxhuar;*
- *Trupin, si e ka përdorur.”* (Tirmidhi, Kiamet, 1.)

Përdorimi i kësaj metode nga ana e mësuesve gjatë mësimit me nxënësit e tyre, do të kishte rezultate mjaft pozitive.

“mos u thuaj atyre (prindërve) as “uh!”, mos i kundërshto, por folu atyre me fjalë respekti.”

(Isra, 23)





NË FILLIM NJË HYRJJE E THJESHTË PASTAJ SHPJEGIM NË DETAJE

Njëra prej cilësive të Pejgamberit të Zotit ﷺ, ishte edhe “Xhevamiul-kelim”, që do të thotë aftësia për të shprehur kuptime të shumta dhe të thella me pak fjalë. Shohim se Pejgamberi ﷺ, e ka përdorur shpesh këtë metodë në bisedat e tij.

Patjetër që këto fjalë, të cilat për t’u kuptuar pa shpjegime kërkojnë një aftësi të lartë dijeje dhe edukimi shpirtëror, bëjnë të mundur që të lindë tek dëgjuesi kureshtja dhe dëshira për të kuptuar. Si përfundim, krijohen mundësitë për ta orientuar atë drejt kuptimit të mesazhit të dëshiruar.

Kjo metodë krijon mundësinë që çështja në fjalë të mbesë më lehtë në kujtesën e njeriut ose të mësohet më lehtë përmendsh. Sepse në fillim tërhiqet vëmendja e dëgjuesit dhe më pas përgatitet për t’u përballur me shpjegimet në detaje.

Hadithet e mëposhtme ofrojnë shembuj të bukur në lidhje me temën në fjalë:

I Dërguari i Allahut ﷺ, duke paralajmëruar ymetin (pasuesit e tij) urdhëron dhe thotë:

“Nuk ka njeri i cili do vdesë dhe nuk do të ndjejë pishmanllëk (keqardhje).”

*Gjestet dhe lëvizjet e fytyrës
tregojnë lehtësi në shprehjen e folësit,
ndaj krijojnë gjithashtu një raport të ngrohtë
në mes tij dhe dëgjuesit.*





“Çfarë është ajo keqardhje o i Dërguari i Allahut?”
- e pyetën.

Pejgamberi ﷺ, u përgjigj:

“Nëse (i vdekuri) është njeri i mirë, i vjen keq që nuk ka punuar më shumë vepra të mira; nëse është njeri i keq, bëhet pishman që nuk është larguar nga punët e këqija dhe ta shpëtonte vetveten.” (Tirmidhi, Zuhd, 59/2403.)

Njëherë i Dërguari i Zotit ﷺ, duke nënvizuar mirësitë e të apasionuarve pas adhurimit, urdhëron dhe thotë:

“Muferrid-ët kaluan të parët!”

Sahabët e pyetën:

“Kush janë muferrid-ët, o i Dërguari i Zotit?”

Atëherë Pejgamberi ﷺ, u shpjegoi:

“Muferrid-ët janë ata të apasionuarit pas adhurimeve. Për shkak se dhikri (përmendja e Zotit) ua ka lehtësuar peshën e gjynaheve prej kurrizit të tyre, ata paraqiten Ditën e Kiametit të lirë (dhe të lehtë).” (Tirmidhi, Deavat, 128/3596.)

Edhe edukatorët mundën të tërheqin vëmendjen e nxënësve të tyre me të njëjtën metodë. Aftësia për të shtyrë nxënësin të bëjë pyetje, është një hap i rëndësishëm në aspektin e realizimit të pjesëmarrjes në mësim. Kjo metodë hap gjithashtu edhe vizione të reja në mendjen dhe inteligjencën e të rinjve.

*Pejgamberi ynë i dashur ﷺ,
duke treguar me shenjë gjuhën e tij të bekuar,
ka thënë: “Njeriu duhet të flasë gjithmonë
të mirën, në të kundërt le të heshtë.”*





BASHKËBISEDIMI DHE METODA E PYETJE-PËRGJIGJEVE

Një prej metodave më të rëndësishme të Pejgamberit ﷺ, ishte ajo e bashkëbisedimit dhe pyetje-përgjigjeve, me qëllim që të tërhiqte vëmendjen e dëgjuesit, duke rritur interesimin në momentin e përgjigjes dhe duke e bërë informacionin më të qëndrueshëm në mendjen e tij.

Hadithi i njohur, i quajtur “Hadithi Xhibril”, është një shembull i bukur për këtë metodë:

Omeri ﷺ, tregon:

Një ditë, kur gjendeshim në prezencën e Pejgamberit ﷺ, u paraqit një njeri i panjohur prej nesh, me rroba të bardha, me flokë të zeza dhe që dukej si një udhëtar. Ai iu afrua Pejgamberit ﷺ dhe u ul pranë tij. U ul gju më gju me të Dërguarin e Allahut dhe e pyeti:

“O Muhamed! Çfarë është Islami?”

I Dërguari i Allahut ﷺ, iu përgjigj:

“Islami është të dëshmosh se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij. Të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh muajin e ramazanit dhe ta vizitosh Shtëpinë e Shenjtë (Qaben), nëse i ke mundësitë për ta bërë një gjë të tillë.”

I panjohuri i tha:

“Biri im i dashur! Mos e mëso ilmin (diturinë) për t’u krekosur me dijetarët, për t’u grindur me të paditurit apo për t’u dukur nëpër mexhlise (tubime).”

(Darimi, Mukaddime, 34/383.)





“Të vërtetën the.”

Ne u habitëm se si ai edhe pyeste edhe miratonte
ato që thoshte Pejgamberi ﷺ.

Më pas udhëtari pyeti:

“Më thuaj çfarë është imani (besimi)?”

I Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

*“Të besosh Allahun, engjëjt e Tij, librat e Tij, pej-
gamberët e Tij, Ditën e Fundit dhe të besosh në caktimin
Hyjnor (kaderin), se e mira dhe e keqja vijnë vetëm prej
Allahut.”*

Shtegtari i panjohur përsëri miratoi:

“Të vërtetën the.”

Pastaj pyeti përsëri:

“Më thuaj çfarë është ihsani (mirësia)?” I Dërguari
i Allahut ﷺ, i tha:

*“Ihsani është ta adhurosh Allahun sikurse e shikon
Atë, edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai me të vërtetë të shikon ty!”*

Personi përsëri tha:

“Të vërtetën the.”

Pastaj vazhdoi:

“Më thuaj kur do të ndodhë Kiameti?”

*Edukimi realizohet me fjalë të ndritura.
Sjelljet dhe fjalët e pahijshme nuk duhet të kenë
vend në institucionet edukative.*





I Dërguari i Allahut ﷺ, i tha:

“I pyeturi nuk di më shumë se sa pyetësi.”

Udhëtari e pyeti:

“Atëherë më trego për shenjat e tij?”

I Dërguari i Allahut ﷺ, u përgjigj:

“Atëherë kur robëresha do të lindë zotërinë e saj dhe do t'i shohësh këmbëzbathurit, fshatarët dhe barinjtë të garojnë se kush ndërton më tepër pallate të larta.”

Pastaj i panjohuri u largua i qetë, ndërkohë që unë qëndrova aty për pak kohë. I Dërguari i Allahut ﷺ, më tha:

“O Omer, a e di ti se kush ishte ai që bëri pyetjet?”

Unë i thashë:

“Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri.”

Atëherë i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“Ai ishte meleku Xhebrail, erdhi t'ua mësojë fenë tuaj.” (Muslim, Iman, 1, 5; Buhari, Iman 37; Tirmidhi, Iman, 4; Ebu Davud, Sunnet, 16.)

Hadithi i mirënjohur si Hadithi i Xhibrilit përmban baza të rëndësishme të cilave u duhet kushtuar rëndësi gjatë aktiviteteve dhe procesit kulturor, edukativ dhe shpirtëror. Këto baza janë shkurtimisht si më poshtë:

*Turpi, si ndjenjë zbukuruese e njerëzimit,
është një mburojë shpirtërore, e cila e
ruan njeriun prej çdo lloji të keqeje.*





1. Edukatori duhet t'i afrohet me dashuri nxënësit. Një sjellje e tillë e bën nxënësin të jetë më i lirë dhe të bëjë pyetje pa nguruar dhe pa ndrojtje.

2. Nxënësi duhet të pyesë me mirësjellje.

3. Nëse dikush afrohet në mexhlin (tubimin) e një dijetari dhe dallon se të pranishmit kanë nevojë të mësojnë për diçka, por po ngurojnë të pyesin, atëherë ai mund të bëjë pyetjet e nevojshme, kështu që përgjigjja e marrë do të jetë e dobishme për të gjithë të pranishmit.

4. Në rastin e pyetjeve dhe përgjigjeve, temat dhe diskutimet e ndryshme dëgjohen më me kujdes dhe kuptohen më mirë.

Për shembull sipas rrëfimit të Ebu Hurejres, Pejgamberi ﷺ, i pyet sahabët (shokët e tij);

"Kush është muflis (i falimentuar), a e dini?" (Me këtë pyetje dëshironte të tërhiqte vëmendjen në një pikë).

Shokët i thanë:

"Ne quajmë të falimentuar atë që nuk ka as para, as pasuri."

Atëherë Pejgamberi ﷺ, kur pa se shokët e tij ishin të gatshëm për të pritur përgjigjen e kësaj pyetjeje, ua shpjegoi atë që me të vërtetë dëshironte të thoshte:

"Pa dyshim që i falimentuari i ymetit (popullit) tim është ai i cili paraqitet në Ditën e Kiametit me sevape të

Aliu ﷺ:

*"Paralajmëroni njerëzit me fjalë të urta
dhe domethënëse, në mënyrë që
zemrat e tyre të gjejnë qetësi."*





namazit, agjërimin dhe zekatit, por ka ofenduar filanin, ka shpifur (për imoralitet) për filanin, ka ngrënë pasurinë e këtij, ka derdhur gjakun e atij, ka rrahur këtë e atë dhe për këtë shkak sevapet e tij i jepen këtij e atij dhe i mbarojnë sevapet akoma pa i mbaruar të drejtat e njerëzve mbi të, (pastaj) i ngarkohen mëkatet e atyre që kanë të drejta mbi të dhe hidhet në Xhehenem.” (Muslim, Birr 59)

Po ashtu, Pejgamberi i Zotit ﷺ, përdor të njejtën metodë kur tregon se si namazi e pastron njeriun prej gjynaheve. Një ditë Pejgamberi ﷺ, i pyet shokët e tij:

“Si mendoni? Sikur përpara shtëpisë së ndonjërit nga ju të rridhte një lumë dhe sikur ai person të lahej në të pesë herë në ditë, a do t'i mbetej ndonjë papastërti?”

Sahabët iu përgjigjën:

“Në atë person nuk do të mbetej asnjë papastërti.”

Atëherë Pejgamberi ﷺ, urdhëron dhe thotë:

“Ja pra, edhe namazi është i ngjashëm me të. Allahu i fshin dhe i pastron gjynahet me anë të pesë kohëve të namazit.” (Buhari, Mevakit 6; Muslim, Mesaxhid 283.)

Gjithashtu Pejgamberi ﷺ, për të motivuar shokët e tij drejt zbukurimit të botës së tyre shpirtërore i pyet:

“A është ndonjëri nga ju i paaftë për të qenë si Ebu Damdam-i?”

“Kush është Ebu Damdam-i?” - e pyetën.

*“Allahu nuk turpërohet
që t’jua thotë të vërtetën.”*

(Ahzab, 53)





I Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“Ka qenë dikush që ka jetuar në popujt para jush. Ai thoshte: “Ua kam bërë hallall atyre që më ofendojnë dhe flasin keq për mua pas krahëve.” (Ebu Davud, Edeb, 36/4887.)

NXITJA E NXËNËSVE PËR TË BËRË PYETJE ME QËLLIM DISKUTIMI DHE DIALOGIMI

Pasi mësuesi shpjegon mësimin, e ndan klasën në dy grupe dhe për secilin grup zgjedh nga tre nxënës. Më pas kërkon prej secilit që t'i bëjnë pyetje njëri-tjetrit. Pasi dy grupet e para mbarojnë me pyetjet, atëherë zgjedh akoma tre nxënës të tjerë, duke bërë kështu të mundur pjesëmarrjen e të gjithë klasës në diskutim. Me anë të formulimit të pyetjeve të ndërsjellta vihet në lëvizje truri i nxënësve, si dhe ruhet vëmendja dhe përqëndrimi në klasë.

Veçanërisht kjo metodë është e rëndësishme, pasi shpreh në një farë mënyre formën e praktikës pedagogjike. Ndërkohë që mësuesi edukon nxënësin e tij, duhet të shikojë edhe mënyrat e formimit të mësuesve të ardhshëm.

FORMIMI I PYETJEVE ME QËLLIM NXITJEN E NXËNËSIT

Prej metodave edukuese të Pejgamberit ﷺ, gjejmë nganjëherë edhe nxitjen e njerëzve në punë të mira me anë të pyetjeve:

*“Sa gra të mira janë gratë e ensarëve.
Turpi nuk i ndalon ato për t'u thelluar
në mësimin e çështjeve të fesë.”*

(Muslim, Hajz, 61.)





Abdurrahman bin Ebu Bekri رضي الله عنه, tregon:

Pasi i Dërguari i Allahut ﷺ, e fali namazin e sabahut, u kthye nga sahabët (shokët e tij) dhe pyeti:

“A është kush agjërueshëm sot?”

“A ka vizituar kush ndonjë të sëmurë sot?”

“A ka ushqyer sot kush ndonjë të varfër?”

Edhe edukatorët me anë të pyetjeve të tilla nxitëse, duhet të krijojnë në klasë një atmosferë gare dhe një konkurrencë pozitive. Në fakt, garat dhe aktivitetet e ndryshme të zhvilluara në ambientet edukative mund të kategorizohen në këtë metodë.

PROVIMI ME ANË TË PYETJEVE

Njeriu fshihet poshtë gjuhës së tij. Prandaj kapaciteti i një personi në diturinë praktike dhe shpirtërore, fshihet pas aftësisë për t’iu përgjigjur saktë pyetjeve që i drejtohen. Edhe Pejgamberi ﷺ, kur e dërgoi Muadh bin Xhebel-in në Jemen, e provoi diturinë e tij duke i drejtuar disa pyetje. Tregohet se:

Një ditë, pas namazit të sabahut, Profeti ﷺ, u kthye nga njerëzit dhe i pyeti;

“O muhaxhirë (emigrues) dhe ensarë (ndihmuesit e emigruesëve)! Kush nga ju shkon në Jemen?” Ebu Bekri رضي الله عنه, tha:

Aliu رضي الله عنه:

*“Gjallëroje zemrën me këshilla,
dhe ndriçoje me urtësi.”*





“Shkoj unë, o i Dërguari i Allahut!”

Pejgamberi ﷺ, heshti dhe nuk i dha përgjigje.

Pyeti përsëri:

“O muhaxhirë dhe ensarë! Kush nga ju shkon në Jemen?”

Këtë herë u ngrit Omeri رضي الله عنه dhe tha:

“Shkoj unë, o i Dërguari i Allahut!”

Pejgamberi ﷺ, përsëri heshti dhe as atij nuk iu përgjigj. Pastaj pyeti për të tretën herë:

“O muhaxhirë dhe ensarë! Kush nga ju shkon në Jemen?”

Ndërsa këtë herë u ngrit Muadh ibn Xhebeli dhe tha:

“Shkoj unë, o i Dërguari i Allahut!”

Atëherë Pejgamberi ﷺ, tha:

“O Muadh, kjo detyrë është e jotja!”

Pastaj u kthye nga Bilali dhe e urdhëroi:

“O Bilal! Ma sill çallmën!”

Kur ia solli çallmën, e mori dhe ia vendosi Muadhrit në kokë dhe pastaj e pyeti:

“Kur të të paraqitet një çështje, si dhe ku do të mbështetesh për të gjykuar?”

“Do të gjykoj sipas Kuranit.” - u përgjigj Muadhi.

*Sado që tema apo çështja
në fjalë të jetë serioze; edukimi nuk duhet
të trajtohet si proces i mërzitshëm
apo të shoqërohet me fytyrë të vrazhdë.*





Pejgamberi ﷺ, e pyeti;

“Nëse dispozitën që kërkon nuk e gjen në Librin e Zotit, atëherë si do ta gjykos?”

“Do të veproj sipas Sunetit të Profetit ﷺ”, - u përgjigj ai.

Pejgamberi ﷺ, e pyeti përsëri:

“Nëse nuk gjen ndonjë dispozitë as në Sunetin e të Dërguarit të Allahut, atëherë si do të veproj?”

“Atëherë do të gjykoj sipas logjikës sime”, - u përgjigj.

Atëherë Pejgamberi ﷺ, e vendosi dorën e tij mbi gjoksin e Muadhit dhe tha:

“Falënderimi i qoftë Allahut i Cili e bëri të denjë delegatin e të Dërguarit të Tij, në ato çka i Dërguari është i kënaqur me të.” (Ahmed, V, 230; Ibn-i Sa'd, III, 584)

Vlerësimi i nxit gjithmonë dëshirat dhe përpjekjet e personit të vlerësuar. Një edukator këtë të vërtetë duhet ta mbajë gjithmonë përpara syve.

Ubejj bin Ka'b-i ؓ, tregon kështu:

Një ditë i Dërguari i Allahut ﷺ, më pyeti;

“O Ebul-Mundhir! Na e thua dot përmendsh ajetin më të madh nga Libri i Allahut?”

Unë i thashë:

Një njeri e thotë një fjalë prej së cilës zemërohet Allahu dhe nuk mendon se dënimi i Allahut do ta gjejë. Porse Allahu, për shkak të asaj fjale, atë person e dënon deri në Ditën e Kiametit, (ditën) kur do të dalë përpara Allahut.”

(Tirmidhi, Zuhd, 12; Ibn Maxhe, Fiten, 12.)





“Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë.”

Pejgamberi ﷺ, më pyeti përsëri:

“O Ebul-Mundhir! Na e thua përmendsh ajetin më të madh nga Libri i Allahut?”

Atëherë unë i thashë;

“Allahu! Nuk ka zot tjetër (që meriton adhurimin) përveç Tij, të Gjallit, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje! Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi!..”
(Bekare, 255.) domethënë Ajetul-Kursij.

Pasi i thashë kështu, i Dërguari i Allahut më preku në gjoks me dorën e tij dhe më tha:

“*Ja pafsh hajrin ilmit (diturisë), o Ebul-Mundhir!*”
(Muslim, Musafirin, 258.)

DYETJET QË SYNOJNË ZHVILLIMIN E INTELIGJENCËS DHE MATJEN E NIVELIT TË LOGJIKËS

I Dërguari i Zotit ﷺ shpeshherë bënte pyetje, me qëllim që të vinte në punë logjikën e njerëzve dhe me këtë formë përcaktonte edhe nivelin e tyre perceptues. Për shembull, nëse dikush pa qenë prezent, lavdërohej nga njerëzit përpara Pejgamberit ﷺ, pyetja e parë që bënte ishte:

“Çfarë niveli mendor ka?”

Ibn Omeri ؓ tregon:

“Kijeni frikë Allahun për njerëzit që ndodhen nën shërbimin tuaj. Kijeni frikë Allahun për dy krijat të dobta: gruan dhe fëmijën jetim. Kijeni frikë Allahun në çështjen e namazit!..”

(Bejhaki, Shuab, VII, 477.)





Ishim pranë Pejgamberit ﷺ, i cili na tha:

“Më tregoni tani, cila pemë i ngjason myslimanit? Ajo pemë është e gjelbër, gjethet nuk i bien kurrë, ajo është kështu e kështu (dhe vazhdoi t’i numërojë cilësitë e saj të bukura). Pastaj lexoi ajetin e Kuranit;

“Me lejen e Zotit të saj (pema) jep fruta në çdo kohë.” (Ibrahim, 25)

Mua më erdhi në mendje pema e hurmës. Por pashë që Ebu Bekri dhe Omeri po flisnin, prandaj nuk e gjeta të përshtatshme që të flisja. Pasi njerëzit nuk dhanë një përgjigje të saktë, i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“Ajo është pema e hurmës.”

Pasi u larguam prej aty, u ktheva nga babai im, Omeri ﷺ dhe i thashë:

“O babai im i dashur, vallahi zemra më thoshte që ajo pemë ishte pema e hurmës.”

“Po mirë, përse nuk e tregove?” - më tha.

“Ngaqë ju nuk folët, edhe unë nuk e pashë të përshtatshme të përgjigjesha!” - i thashë.

Babai më tha kështu:

“Nëse ti do të përgjigjeshe, ajo për mua do të ishte më e mirë se kjo apo ajo (vepër)...” (Buhari, Tefsir, 14/1.)

Njëherë Rabia el Adevije shikoi dikë që kishte lidhur kokën me fasho dhe e pyet:

“Përse e ke lidhur kokën me fasho?”

*Njeriu kur është i qeshur apo i gëzuar
mëson më shumë dhe më shpejt sesa kur
qëndron me fytyrë të vrazhdë.*





“Më dhemb koka, prandaj.”

“Sa vjeç je?”

“Tridhjetë.”

“Po mirë, gjatë këtyre tridhjetë vjetëve trupi yt ka qenë më shumë i shëndetshëm apo më shumë i sëmurë?”

“Ka qenë më shumë i fortë dhe i shëndetshëm.”

“Qoftë edhe për një moment, a e ke lidhur ndonjëherë fashon e falënderimit? Përse e lidhe menjëherë fashon e ankimit sapo filloi të të dhembë koka?”

(Fariduddin Attar, Tezkiretu'l-Evliya, I, 104.)

Një person i cili i është përkushtuar edukimit, duhet patjetër të ketë parasysh kapacitetet e ndryshme të nxënësve të tij. Në qoftë se në një klasë të përbashkët gjenden nxënës me aftësi dhe kapacitete të ndryshme, atëherë mund të ndodhë që dikush do të dëgjojë mësimin, ndërsa dikush tjetër do të mërzitet.

RREGULLAT E DHËNJES SË PËRGJIGJEVE

KUR PËRGJIGJJA I LIHET NXËNËSIT

Nganjëherë i Dërguari i Allahut ﷺ, përgjigjet e pyetjeve të cilat i drejtoheshin atij, ua linte shokëve, me qëllim që t'i zhvillonte dhe t'i edukonte ata.

Ibn Abbasi ؓ, tregon:

*“Ulerësoji pesë gjëra përpara se të vijë pesë të tjera!
• Rininë përpara pleqërisë; • Shëndetin përpara sëmundjes; •
Pasurinë përpara varfërisë; • Kohën e lirë përpara se të jesh i
zënë; • Jetën përpara se të vijë vdekja.”*

(Hakim, IV, 341/7846.)





“Erdhi një burrë tek i Dërguari i Allahut ﷺ dhe i tregoi këtë ëndërr:

“Mbrëmë kam parë në ëndërr diçka e cila i ngjante një reje dhe prej saj rridhte vaj dhe mjaltë. Ndërsa njerëzit kishin hapur duart dhe mundoheshin të merrnin prej tij. Kishte prej tyre që merrnin shumë pak dhe kishte të tjerë të cilët merrnin më shumë. Më vonë pashë një litar që zgjatej prej qiellit deri në tokë. Ti u kape për atë litar dhe u ngjite lart. Pas teje u kap edhe dikush tjetër. Edhe ai u ngjit. Pastaj u ngjit një tjetër, e pastaj një tjetër u kap pas litarit, por litari u këput. Më pas e shtuan litarin, pastaj edhe ai u ngjit.”

Ebu Bekri رضي الله عنه, u hodh dhe tha:

“O i Dërguari i Allahut, nëna dhe babai im të qofshin falë, më lejo ta komentoj unë këtë ëndërr!”

“Mirë atëherë, komentoje!” - i tha i Dërguari i Allahut ﷺ.

Ebu Bekri رضي الله عنه, vijoi kështu:

“Ajo hije e resë së shiut është reja e Islamit. Shiu prej vaji dhe mjalti është Kurani. Është ëmbëlsia (si mjaltë) dhe butësia (si vaj) e Kuranit. Marrja pak prej tij (vajit apo mjaltit) e disa njerëzve dhe marrja shumë prej tij e disa të tjerëve, tregon se disa persona përfitojnë shumë prej Kuranit, ndërsa disa të tjerë më pak. Litari i zgjatur prej qiellit e deri në tokë është e vërteta që ti ke sjellë. Ti je kapur në të, prandaj Allahu do të lartësojë. Pas teje di-

*“Askush nuk lëviz prej vendit të tij Ditën e Kiametit derisa të japë llogari për; • Jetën, ku e ka harxhuar;
• Diturinë, si e ka shfrytëzuar; • Pasurinë, ku e ka fituar dhe si e ka harxhuar; • Trupin, si e ka përdorur.”*

(Tirmidhi, Kiamet, 1.)





kush do të kapet për të dhe do të lartësohet, pastaj akoma dikush do të kapet për të, dhe ai do të lartësohet. Pastaj e provon edhe një tjetër, por litari këputet. Më pas litari lidhet përsëri, edhe ai kapet në të dhe ngjitet.

O i Dërguari i Allahut, nëna dhe babai im të qofshin falë, më trego nëse e komentova drejt apo jo!”

I Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“Në disa komente ia arrite, ndërsa në disa të tjera gabove.” (Buhari, Ta’bir 11, 47; Muslim, Ru’ja 17)

Një rast tjetër e tregon Ukbe bin Amir ؓ:

Erdhën dy persona tek i Dërguari i Allahut ﷺ dhe ia paraqitën çështjen e tyre për gjykim. I Dërguari i Allahut ﷺ, më urdhëroi dhe më tha:

“Ngrihu o Ukbe! Gjyko në mes të këtyre të dyve!”

Unë i thashë;

“O i Dërguari i Allahut! Ti e meriton më shumë sesa unë vendimin në këtë çështje.”

I Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“Edhe pse është ashtu, (këtë herë) gjyko ti në mes tyre. Nëse i përdor të gjitha mundësitë e tua dhe jep një vendim të drejtë fiton dhjetë sevape. Nëse i përdor të gjitha aftësitë e tua dhe jep një vendim të gabuar, atëherë fiton një sevap.” (Ahmed, IV, 205.)

Po ashtu, edhe gjatë procesit edukativ, është më

Edukatori duhet t'i afrohet me dashuri pyetësit ose ta afrojë atë pranë tij. Një sjellje e tillë e bën nxënësin të jetë më i lirë dhe të bëjë pyetje pa nguruar dhe pa u shqetësuar.





mirë që në momentet kur mësuesi pyetet për diçka, të mos përgjigjet menjëherë, por të shikojë nëse në mesin e nxënësve ka ndonjë që dëshiron të japë një përgjigje. Në këtë mënyrë ia ofron atyre mundësinë e dhënies së përgjigjes. Një formë e tillë, duke ia kaluar nxënësit përgjigjen e pyetjes së bërë, aktivizon më shumë mësimin dhe nxit më shumë në studim. Kjo gjë është gjithashtu prej formave të edukimit pedagogjik.

PËRGJIGJA E PYETJES ME “AS MË PAK DHE AS MË SHUMË” POR E PLOTË DHE E PËRMBLEDHUR

Përgjigjet e pyetjeve të cilat i drejtoheshin Pejgamberit ﷺ, ishin të përmbledhura dhe mjaft të qarta. Në këtë mënyrë Ai kontrollonte vëmendjen e dëgjuesit dhe i jepte atij atë çka kishte nevojë në një kohë më të shkurtër.

Nevvas bin Sem'an ﷺ, tregon kështu:

Qëndrova pranë të Dërguarit të Allahut në Medine një vit (si mysafir)... Njëherë e pyeta se çfarë është mirësia dhe çfarë është mëkati. Ai ﷺ, urdhëroi dhe tha:

“Mirësia është morali i bukur. Ndërsa mëkati është ajo gjë e cila nuk gjen qetësi në shpirt dhe nuk dëshiron që njerëzit ta dinë.” (Muslim, Birr, 14-15.)

Përgjigjja e pyetjes së bërë në formë të përmbledhur, të prerë dhe të qartë, ndikon më shumë tek pyetësi. Për-

“Njeriu thotë një fjalë prej të cilës Allahu është i kënaqur me të, por nuk i shkon mendja që do të fitojë kënaqësinë e Allahut. Allahu ﷻ për shkak të asaj fjale është i kënaqur me atë person deri në Ditën e Kiametit, (ditën) kur do ta takojë Allahun.

(Tirmidhi, Zuhd, 12; Ibn Maxhe, Fiten, 12.)





gjigjja e shkurtër por e qartë, ndihmon të kuptuarit më lehtë. Ndërsa përgjigjja e stërzgjatur nuk e ka atë ndikim dhe forcë që ka përgjigjja e përmbledhur.

PËRGJIGJJA SIPAS NEVOJËS SË PYETËSIT

Edukatori duhet të gjejë një damar i cili depërton në shpirtin e nxënësit të tij. Pejgamberi ﷺ, sillej me një-rëzit sipas nivelit të tyre dhe i ndihmonte ata për hallet dhe problemet që kishin. Për shembull, vinte dikush dhe pyeste:

“O i Dërguari i Allahut, cila punë është më e hajrit për mua?” Nëse ai person ishte i pasur, por nuk dinte se si ta përdorte pasurinë e tij, atëherë Pejgamberi ﷺ, ia mësonte se si duhej ta shpërndante pasurinë.

Dikush ishte mjaft i varfër. Atëherë e këshillonte të bënte durim.

Dikush tjetër ishte mjaft gjaknxehtë, atë e këshillonte duke i thënë “mos u zemëro!”

Zemërimi dhe gjaknxehtësia i fshinte të gjitha punët e tij të mira. Për këtë arsye, ky lloj edukimi nuk është një profesion i kollajtë. Është një zanat që e ka burimin tek Pejgamberi ﷺ.

Prandaj edhe edukatorët duhet të arrijnë të kuptojnë qëllimin e vërtetë të pyetjes dhe të ofrojnë përgjigjen e përshtatshme për pyetësin, sidomos atëherë kur me

*Asnjë përrua apo lumë nuk ngjitet dot në mal.
Nëse ndonjëri prej tyre dëshiron të kapërcejë malin,
atëherë atij i duhet të kalojë anash atij. Në këtë mënyrë
gjatësia e rrugës së dëshiruar zgjatet, por kështu
arrihet dëshira dhe qëllimi i caktuar.*





anë të pyetjeve të veçanta (provokative) kërkohet një përgjigje e caktuar. Pikërisht atëherë mësuesi duhet të dijë se si të përgjigjet me zgjuarsia.

PËRGJIGJET JO SIPAS DËSHIRËS SË PYETËSIT POR SIPAS NEVOJËS SË TIJ

Nganjëherë sahabët (shokët) e pyesnin Pejgamberin ﷺ, në lidhje me një çështje, ndërsa Pejgamberi ﷺ, për shkaqe të ndryshme, më të mira dhe më pozitive, e shpjegonte pyetjen në një kontekst tjetër. Gjatë shpjegimit prekte ato pika për të cilat pyetësi kishte më shumë nevojë. Domethënë nuk jepte përgjigjen e pritur, por ofronte shpjegime më të përshtatshme dhe më të dobishme për të mirën e pyetësit. Në gjuhën arabe kësaj forme i thonë “uslub-i hakim” (metoda mbizotëruese). Shembullin e kësaj metode e shohim në këtë hadith:

Sahabët e nderuar (shokët e Pejgamberit a.s.) e kishin pyetur njëherë:

“O i Dërguari i Allahut, e shohim të hollë si pe hënë kur lind, pastaj ajo zmadhohet, bëhet e rrumbullakët, pastaj fillon përsëri të pakësohet (hollohet) derisa kthehet në formën e parë të saj të hollë. Përse nuk qëndron në një formë?”

Allahu i Lartësuar ishte përgjigjur me këtë ajet të Kuranit:

*Edukatorët me anë të pyetjeve të tilla nxitëse si për shembull:
“Le të shohim se kush do t’i përgjigjet kësaj pyetjeje...?”
duhet të krijojnë në klasë një atmosferë garimi
dhe një konkurrencë pozitive.*





**“Të pyesin ty (o Muhamed) për hënat e reja. Thu-
aju: “Ato janë për njerëzit shenja përcaktuese të kohës
dhe të haxhillëkut?” (Bekare, 189)**

Pyetja e sahabëve drejtuar Pejgamberit ﷺ, kish-
te për qëllim anën fizike të hënës. Ndërsa në ajetin e
Kuranit nënvizohet roli i rëndësishëm që ka hëna në
jetën e njerëzve. Me anë të kësaj përgjigjeje nënvizohet
domosdoshmëria e drejtimit të njeriut nga gjërat e
dobishme dhe jo harxhimi i kohës me gjëra të cilat nuk
i interesojnë.

Dikush vjen tek i Dërguari i Allahut ﷺ dhe e pyet:

“O i Dërguari i Allahut! Kur do të ndodhë Kiameti?”
- ndërsa Pejgamberi ﷺ, ia kthen:

“Çfarë ke përgatitur për të?”

Ai thotë:

“Nuk kam përgatitur shumë namaz, agjërime dhe
sadaka (lëmshë), por Allahun dhe të Dërguarin e Tij
i dua shumë.”

Atëherë Pejgamberi ﷺ, i thotë;

“Ti do të jesh me ata që do!” (Buhari, as’habun-Nebi, 6.)

Me anë të kësaj përgjigjeje, Pejgamberi ﷺ, ia tërheq
vëmendjen dhe e nxit pyetësin në përgatitjen e punëve
të mira të cilat do të jenë shumë më të dobishme për
të në Ahiret (botën tjetër), sesa të lodhet duke kërkuar

*Njeriu fshihet poshtë gjuhës së tij.
Prandaj kapaciteti i një individi në diturinë praktike
dhe shpirtërore, fshihet tek aftësia për t’iu përgjigjur
pyetjeve që i drejtohen.*





se kur do të bëhet Kiameti, gjë të cilën i Madhi Zot me mirësinë e Tij e ka fshehur dhe nuk ia ka treguar askujt.

I Dërguari i Allahut ﷺ, gjithashtu e ka ndaluar ymetin (popullin, pasuesit) e tij që të shoqërohen me shokë të këqinj. Meqë njeriu do të jetë së bashku me ata që do, edhe personi që shoqërohet me shokë të këqinj, do të jetë së bashku me ta në botën tjetër.

Prandaj ai që nuk dëshiron të përballet me ndonjë gjendje të vështirë në Ahiret, duhet të distancohet nga shoqëria e keqe.

Vjen një beduin te Profeti ﷺ dhe e pyet:

“Si mendon për dikë që lufton për t’u dukur, për të fituar plaçkë lufte, për t’u përmendur apo për nder dhe krenari?”

Ndërsa një tjetër e pyet:

“O i Dërguari i Allahut! Çfarë është lufta në rrugë të Zotit? Dikush lufton prej zemërimit e dikush prej patriotizmit.”

I Dërguari i Allahut ﷺ, urdhëron dhe thotë;

“Kush lufton me qëllimin e vetëm për të ngritur lart fjalën e Zotit, ai ka luftuar në rrugën e Zotit!” (Buhari, Ilim, 45; Muslim, Imare, 149-150.)

Një nga metodat e bukura të “uslub-i hakim” (metoda mbizotëruese) është edhe Kurani Famëlartë.

*“Por, nëse shmangesht nga ata
(kur nuk ke asgjë për të dhënë), duke shpresuar
në mëshirën e Zotit tënd, atëherë thuaju
atyre ndonjë fjalë të butë.”*

(Isra, 28)





Pyetjes drejtuar Pejgamberit ﷺ, se çfarë duhet të japin (si sadaka), Kurani i Lavdishëm u përgjigjet se nuk është e rëndësishme se çfarë ofrohet si sadaka, por e rëndësishme është se ku dhe kujt do t'i shpërndalet ajo pasuri.

“Të pyesin ty se çfarë mund të japin si lëmoshë.

Thuaju: Çfarëdo bamirësie që bëni, ajo le t'u takojë prindërve, farefisit, jetimëve, të varfërve dhe udhëtarëve. Çfarëdo të mire që bëni, Allahu e di atë.”

(Bekare, 215)

Kështu, një pyetjeje të thjeshtë fikhu, i jepet një përgjigje e cila shpërndan mëshirë gjithandej. Brenda përgjigjes është e mundur të gjejmë edhe një domethënie të tillë:

“Duke pasur kaq shumë adresa ku mund të ofrosh ndihmën tënde, duke pasur kaq shumë nevojtarë, ti jepe atë çka duhet të japësh...”

Mësuesi i cili e kontrollon situatën, i ka mundësitë për të edukuar nxënësin më lehtë dhe më mirë në sajë të kësaj metode. E shpëton atë nga zënia e kohës me gjëra të panevojshme duke e orientuar drejt objektivit dhe synimeve pa u lodhur.

METODA E PËRSËRITJES

Përsëritja është një metodë e rëndësishme në procesin e edukimit. Mendja e njeriut mund ta kuptojë

*Mirësia është morali i bukur.
Ndërsa mëkati është ajo gjë e cila nuk gjen qetësi në shpirt
dhe nuk dëshiron që njerëzit ta dinë.”*

(Muslim, Birr, 14-15.)





diçka në dëgjim të parë, por nuk mund ta gdhendë mirë atë në memorjen e tij. Për këtë gjë, njeriu ka nevojë për një përsëritje sistematike.

Shumë ajete në Kuranin Famëlartë përsëriten.

Për shembull ajeti: “Mjerë mohuesit në atë ditë!” në suren Murselat është përsëritur dhjetë herë.

Ajeti: “Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!” në suren Rrahman është përsëritur tridhjetë e një herë.

Gjithashtu, mendjemadhësia e iblisit dhe mospranimi i sexhdes përballë Ademit **عليه السلام**, është përsëritur shumë herë.

E njëjta ngjarje tregohet duke nënvizuar aspekte të ndryshme të saj dhe sipas rrjedhës së ngjarjes nxirren edhe kuptime të ndryshme.

Po ashtu, gjatë bisedës në lidhje me rëndësinë që ajo përmban, përdoret shpesh metoda e përsëritjes me qëllim që të tërhiqet vëmendja, biseda të dëgjohet nga të gjithë dhe të ngulitet më mirë në mendjen e tyre.

PËRSËRITJA E FJALËS TRI OSE MË SHUMË HERË

Ashtu sikurse uji e shpon gurin duke e goditur vazhdimisht në të njejtën pikë, edhe insistimi i vazhdueshëm e gdhend informacionin dhe diturinë në mendjen dhe në zemrën e njeriut.

Përgjigja e shkurtër, por e qartë, ndihmon të kuptuarit më lehtë. Ndërsa përgjigja e stërgjatur nuk e përmban atë ndikim të cilin e ka përgjigja e përmbledhur.





Enesi ﷻ, tregon kështu:

Në momnetet e fundit të jetës së të Dërguarit të Allahut ﷺ, ndodheshim pranë tij. Na tha tri herë:

“Kijeni frikë Allahun në çështjen e namazit!” - pastaj vazhdoi me fjalët:

“Kijeni frikë Allahun për njerëzit që ndodhen nën shërbimin tuaj! Kijeni frikë Allahun për dy kategoritë e të pafuqishëmve: gruan dhe fëmijën jetim. Kijeni frikë Allahun në çështjen e namazit!..”

Më pas i Dërguari i Allahut ﷺ, filloi të përsëriste fjalët: *“Namazi, namazi...”* (edhe pse gjuha e tij nuk lëvizte dot) vazhdoi ta përsëriste këtë fjalë me vete derisa shpirti i tij i pastër u ngjiti në Refik-i A'la. (Bejhaki, Shuab, VII, 477.)

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë kështu:

“Kini kujdes! Punët që të shpien në Xhenet janë të vështira si një rrugë e ngushtë dhe me pengesa. (I Dërguari i Allahut ﷺ, e përsëriti tri herë këtë fjali). Ndërsa punët që të shpien në Xhehenem janë të lehta si një rrugë e rrafshët dhe pa pengesa.” (Ahmed, I, 327.)

Me kusht që të mos bëhet me tepri, përsëritja është një metodë e rëndësishme në edukim.

Përsëritja duhet të bëhet në rast se është e nevojshme për studentin ose nëse tema përmban rëndësi të veçantë. Përndryshe ajo mund të krijojë pakënaqësi tek nxënësit me kapacitete të zhvilluara.

*“Këta janë ata për të cilët
Allahu e di se ç'kanë në zemrat e tyre. Largohu prej tyre,
këshilloji dhe thuaju fjalë që i prekin në zemër.”*

(Nisa, 63)





Një mësues i cili nuk paraqet plan sistematik gjatë mësimeve të tij, por vazhdon të përsërisë të njëjtën temë duke lënë pas dore temat e tjera, atëherë ai është dembel dhe nuk zbaton metodën e përsëritjes.

SHpjegim mbreslënë

ME ANË TË SHEMBUJVE DHE KRAHASIMEVE

Mendja e njeriut i koncepton më mirë bisedat e shoqëruara me shembuj. Kurani Ndriçues shpeshherë paraqet shembujt krahasues me qëllim përforcimin e kuptimit të ajeteve. Për shembull, ndërsa flitet për cilësitë e besimtarëve, na paraqitet ky krahasim:

“...shembulli i tyre përshkruhet si një farë e mbjellë që lëshon filiza e forcohet e pastaj ngrihet e fortë me kërcellin e vet, duke i gëzuar mbjellësit. (Kështu përshkruhen ata) me qëllim që, nëpërmjet tyre, Ai t’i zemërojë mohuesit. Për ata që besojnë midis tyre dhe kryejnë vepra të mira, Allahu ka premtuar falje dhe shpërblim të madh.” (Fetih, 29)

I Dërguari i Allahut ﷺ, çështjet e paqarta i shpjegonte duke i bërë më të lehta për t’u kuptuar me anë të shembujve konkretë. Ja disa hadithe:

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Gjendja në mes meje dhe jush i ngjan këtij shembulli:

*Edukimi nuk është një profesion i çfarëdoshëm,
por një profesion profetik. Është një profesion i cili e
ka burimin tek Pejgamberi ynë i dashur ﷺ.*





Një njeri ndez një zjarr (natën). Me t'u ndriçuar vendi, fluturat e natës dhe disa gjallesa të cilave u pëlqen drita fillojnë të hidhen në zjarr. Njeriu i gjorë mundohet që t'i ndalojë ato, por shumica e këtyre insekteve duke iu shmangur atij bien në zjarr.

Unë ju kap për beli, me qëllim që të mos përfundoni në zjarr, ndërsa ju vraponi për t'u hedhur në të.” (Buhari, Rikak, 26; Muslim, Edeb, 82; Ahmed, II, 244.)

Ndërsa në një mesazh tjetër shprehet:

“Ju çliroheni menjëherë nga duart e mia dhe hidheni në zjarr.” (Sujuti, el-Xhami, h.no: 8168; er-Ramehurmuzi, 22; Ajni, XXIII, 76.)

“Besimtari i ngjan bletës. Ha atë që është e pastër, prodhon atë që është e pastër, qëndron në vende të pastra dhe aty ku qëndron as nuk thyen, as nuk dëmton.” (Ahmed, II, 199; Hakim, I, 147; Sujuti, el-Xhami, h.nr: 8147.)

I Dërguari i Allahut ﷺ, urdhëron dhe thotë:

“Kur të hyni në kopshtet e Xhenetit hani (nga frutat e tyre) sa të mundeni”. Ebu Hurejre ؓ, e ka pyetur:

“Cilët janë kopshtet e Xhenetit, o i Dërguari i Allahut? Pejgamberi ﷺ, përgjigjet:

“Xhamitë...”

Përsëri Ebu Hurejre ؓ, e pyet:

“Si mund të hahen frutat e tyre, o i Dërguari i Allahut?

Edukatorët duhet ta kuptojnë kontekstin e pyetjes dhe në varësi të saj duhet të ofrojnë përgjigjen e nevojshme.





Pejgamberi ﷺ, përgjigjet;

“(duke thënë) Subhane’Allah, Elhamdulilah, La ilahe il-l’Allah, Allahu Ekber.” (Tirmidhi, Deavat, 82/3509.)

Hadithi i mëposhtëm i Pejgamberit ﷺ, është pasuri e veçantë në paraqitjen e shembujve dhe krahasimeve:

“...Pejgamberi Jahja ﷺ, i mbloodhi njerëzit në Bejtul-Makdis. Xhamia ishte e tejmbushur. Njerëzit u ulën edhe nëpër shkallë. Ai e mori fjalën dhe tha:

“Allahu m’i dërgoi pesë fjalë dhe më urdhëroi që të veproj me to; dhe më urdhëroi që t’ju urdhëroj që edhe ju të veproni me to:

Njëra prej tyre është adhurimi i vetëm i Allahut dhe mos shoqërimi i Tij me asgjë tjetër. Shembulli i atij i cili i bën shok Allahut është kështu: Një person blen një skllav me pasurinë e tij, me flori apo argjend dhe e urdhëron: “Kjo është shtëpia ime, ndërsa kjo është puna ime. Puno dhe me fitimin më paguaj mua!” Skllavi punon, por fitimin nuk ia jep zotërisë së tij, por dikujt tjetër. Cili nga ju do të ishte i kënaqur me veprimin e këtij skllavi? Pikërisht kështu, Allahu ju ka urdhëruar namazin. Kur të jeni në namaz mos shikoni majtas e djathtas, sepse Allahu e kthen shikimin drejt robit të Tij, përderisa ai është në namaz, dhe nuk e kthen shikimin majtas apo djathtas.

Allahu ju ka urdhëruar agjërimin. Shembulli i tij i ngjan shembullit të atij njeriu që ndodhet së bashku me një grup njerëzish. Në xhepin e tij gjendet një qese e vogël

*“O besimtarë, frikësohuni nga Allahu
dhe thoni vetëm të vërtetën!”*

(Ahzab, 70)





me misk (erë e mirë). Të gjithë kënaqen me erën e tij të mirë. Era e gojës së agjëruesit është më e mirë tek Allahu, sesa era e miskut.

Allahu ju ka urdhëruar sadakanë. Shembulli i saj i ngjan shembullit të atij që armiqtë e kanë zënë atë rob, ia kanë lidhur duart dhe po e dërgojnë tek xhelati për t'ia prerë kokën.

Ai thotë: “Unë dua të jap pak ose shumë prej pasurisë që kam në këmbim të lirisë time”, - kështu e shpëton veten.

Allahu ju ka urdhëruar gjithashtu që ta përmendni shumë Atë. Ndërsa shembulli i tij është si i atij drejt të cilit armiqtë po vrapojnë me shpejtësi për ta kapur. Ai mund të shpëtojë vetëm nëse strehohet brenda një kështjelle të fortë. I njëjtë është edhe njeriu. Ai mund të shpëtojë prej djallit vetëm duke përmendur Allahun.”

Pastaj i Dërguari i Allahut ﷺ, vazhdoi dhe tha:

“Edhe unë po ju urdhëroj pesë gjëra. Allahu m'i urdhëroi ato mua. Dëgjimin, bindjen, xhihadin, emigrimin (për hirë të fesë) dhe xhematin. Kush largohet prej xhematit sa një pëllëmbë, e ka këputur lidhjen e tij me Islamin, përveç atij që kthehet. Ndërsa kush propagandon ideologji të periudhës paraislame (periudhës së injorancës), do të jetë prej lëndëve djegëse të Xhehenemit!” (Tirmidhi, Edeb 78/2863; Ahmed, IV, 130, 202.)

Të gjithë këta shembuj na tregojnë se i Dërguari i Allahut ﷺ, i cili ishte dërguar si modeli më i mirë, e

Ueçoria e parë e domosdoshme e fjalës së moralshme është vërtetësia e saj (të qenit e vërtetë). Sadoqë fjalët tona të jenë të buta, të ëmbla ose ndikuese, nëse gjuha jonë nuk shpreh të drejtën ose nuk flet të vërtetën, ajo është e kotë dhe e pavlerë.





përdorte shpesh metodën edukative me shembuj dhe krahasime, për shkak se ajo lehtëson kuptimin dhe lejon një perceptim më të lehtë për njeriun. Ajo që u kërkohet edukatorëve të sotëm është përdorimi sa më i shpeshtë i kësaj metode, sepse metodat me shembuj dhe krahasime paraqesin veçorinë e përforcimit të aftësive edhe për ata persona të cilët nuk e kanë akoma të zhvilluar mjaftueshëm kapacitetin e logjikës.

Një person i cili dëgjon këtë hadith të Profetit ﷺ, arrin të krijojë një koncept të qartë në botën e tij shpirtërore mbi atë që quhet e mirë apo e keqe:

“Shembulli i atij që bën keq, pastaj kthehet dhe bën vepra të mira, i ngjan këtij shembulli: Një person ka të veshur një mburojë shumë të ngushtë, saqë po ia merr frymën. Kur bën një të mirë, zgjidhet njëra prej lidhëzave të saj, bën edhe një të mirë tjetër dhe zgjidhet akoma edhe një lidhëz, edhe një tjetër edhe një tjetër, derisa shpëton nga mburoja e ngushtë dhe qetësohet.” (Ahmed, IV, 145.)

PËRFORCIMI ME BETIM

Betimi është një formë përforcuese që përdoret shumë në gjuhën arabe. Allahu ﷻ, betohet në sendet dhe gjallesat, me qëllim që të tërheqë vëmendjen tonë dhe i përgatit mendjet drejt fjalisë kryesore e cila është përgjigjja e këtij betimi:

“Për fikun dhe ullirin, për malin e Sinait dhe për këtë Qytet të sigurt (Mekën), Në të vërtetë, Ne e krijuam

“Kini kujdes! Punët që të shpien në Xhenet janë të vështira, si një rrugë e ngushtë dhe me pengesa. (i Dërguari i Allahut ﷺ, e përsëriti tri herë këtë fjali)...”

(Ahmed, I, 327.)





njeriun në trajtën më të përkryer, pastaj e çuam atë (kur nuk beson) në gjendjen më të ulët.” (Tin, 1-5)

I Dërguari i Allahut ﷺ, e përdorte metodën e betimit për të forcuar fjalinë dhe për të treguar rëndësinë e çështjes në fjalë. Me këtë metodë gjithashtu arrinte të tërhiqte edhe vëmendjen drejt fjalëve që do të thoshte.

Sipas transmetimit të Ebu Hurejres رضي الله عنه, Profeti ﷺ, ka thënë:

“Vallahi nuk ka besuar. Vallahi nuk ka besuar. Vallahi nuk ka besuar!”

Sahabët e pyetën;

“Kush nuk ka besuar, o i Dërguari i Allahut?”

Pejgamberi ﷺ, tha:

“Ai që bën fqinjin e tij të mos ndihet i sigurt, për shkak të veprave të tij të këqija!” (Buhari, Edeb 29; Muslim, Iman 73; Tirmidhi, Kiamet 60.)

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë kështu:

“Unë shikoj atë që ju nuk e shikoni dhe dëgjoj atë që ju nuk e dëgjoni. Qielli po pëlcet. Pëlcitja e tij është më se normale. Sepse nuk ka as edhe një vend bosh sa katër gishta ku të mos ndodhet një melek (ëngjell), i cili e ka vendosur ballin e tij në tokë për t'i bërë sexhde Allahut. Beto hem në Allahun, sikur ju të dinit atë çfarë di unë, do të qeshnit pak dhe do të qanit shumë. Nuk do të kalonit

“Punët që të shpien në Xhehenem janë të lehta, si një rrugë e rrafshhtë dhe pa pengesa.”

(Ahmed, I, 327)





kohë me bashkëshortet tua, por do të lëshoheshit nëpër rrugë duke kërkuar më zë të lartë ndihmën e Allahut.”

Cituesi i këtij hadithi, Ebu Dherri ka thënë;

“Sa do të dëshiroja të isha një pemë, të më prisnin dhe të më hanin, në vend që të përballesha me këtë gjendje të frikshme!” (Tirmidhi, Zuhd, 9/2312.)

Por nuk duhet harruar se betimi përmban edhe disa konsequenca në aspektin juridik. Ashtu sikurse vihet re edhe në vendin tonë, është bërë zakon që njerëzit të betohen vazhdimisht edhe për gjëra të thjeshta. Kjo, në aspektin gjuhësor, nuk përmban asnjë formë përforcimi fjalie apo kuptimi.

SHDJEJIMI ME FORMA TË NDRYSHME

Shprehjet gjuhësore kanë disa pajisje mbështetëse apo ndihmëse. Kështu në ditët e sotme, përdorimi i mjeteve të ndryshme, si: dërrasa e zezë në klasë, projektori, televizori, kompjuteri, etj., ndihmojnë jo vetëm në pjesëmarrjen e shqisave të dëgjimit, por edhe të atyre të të parit.

Një metodë të ngjashme ka përdorur edhe i Dërguari i Allahut ﷺ, shumë shekuj përpara:

Abdullah ibn Mes’udi ﷺ, na tregon kështu:

Pejgamberi ﷺ, vizatoi një katror në tokë. Duke u nisur nga mesi i katrorit bëri një vijë e cila dilte jashtë

Një besimtar, moralin e gjuhës e mëson nga Kurani i madhërueshëm. Sepse Kurani për besimtarët, në aspektin e moralit gjuhësor, ashtu sikurse në çdo aspekt tjetër të jetës, është udhërrëfyesi më i mirë i cili ua mëson gjuhën kuranore.





duke prerë njërin prej cepave të tij. Nga të dyja anët e kësaj vije vizatoi drejt tij disa vija të tjera më të vogla. Pastaj duke treguar ato vija urdhëroi dhe tha kështu:

“Ky është njeriu, ndërsa ky është exheli, fundi i jetës së tij. Vija e cila e pret katrorin dhe del jashtë, janë dëshirat e njeriut.

Vijat e tjera të vogla përreth kësaj vije janë hallet dhe vuajtjet.

Nëse njeriu shpëton prej njërit nga këto probleme, vjen një tjetër dhe e gjen. Nëse shpëton prej atij, një tjetër vjen dhe e godet.” (Buhari, Rikak, 4.)

Xhabiri ﷺ, tregon:

Ndërsa isha i ulur pranë të Dërguarit të Allahut ﷺ, vizatoi përpara tij një vijë dhe tha:

“Kjo është rruga e drejtë e Allahut të Lartësuar.”

Pastaj vizatoi në të dyja anët e kësaj vije edhe nga dy vija të tjera dhe tha:

“Ndërsa këto janë rrugët e shejtanit.”

Më pas e vendosi dorën e tij të bekuar mbi vijën në mes dhe lexoi këtë ajet të Kuranit:

“Kjo është rruga Ime e drejtë; prandaj ndiqeni e mos shkoni rrugëve të tjera që t’ju shmangin nga rruga e Tij. Kjo është ajo që ju porosit Ai për t’u ruajtur nga të këqijat.” (En’am, 153) (Ahmed, III, 397.)

“Për fikun dhe ullirin, për malin e Sinait dhe për këtë Qytet të sigurt (Mekën). Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer, pastaj e çuam atë (kur nuk beson) në gjendjen më të ulët.”

(Tin, 1-5)





PËRDORIMI I GJESTEVE DHE MIMIKËS

Disa prej metodave të cilat e shtojnë ndikimin e fjalës, përforcojnë shprehjet dhe zbukurojnë të folurit, janë edhe përdorimi natyral i gjeleve dhe mimikës.

Pejgamberi ﷺ, përdorte natyrshëm lëvizjen e duarve dhe të fytyrës, me qëllim që të përforconte formën treguese ose për të tërhequr vëmendjen e njerëzve përreth.

Edukatori nuk duhet të mjaftohet vetëm me përcjelljen e mesazheve të tij tek nxënësi, por me anë të gjeleve dhe mimikës, duhet të përpiqet që të tërheqë edhe përqendrimin dhe shikimin e tij.

Gjestet dhe mimika tregojnë lehtësinë e shprehjes së ligjërujesit dhe në të njëjtën kohë krijojnë një lidhje të ngrohtë në mes të folësit dhe dëgjuesit.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka dhënë një shembull mjaft interesant të kësaj metode që në ditët e para të dërgimit të tij si pejgamber.

Duke biseduar me pjesëtarët e fisit Hashimi, u thotë kështu:

“Nëse ju më paraqiteni Ditën e Kiametit me dynjanë të ngarkuar mbi supe dhe jo me veprat tua të mira, atëherë unë do t’ua kthej shpinën.

Atëherë ju do më thërrisni: “O Muhamed!” Ndërsa unë do të veproj kështu.”

“Kjo është rruga Ime e drejtë; prandaj ndiqeni e mos shkonit rrugëve të tjera që t’ju shmangin nga rruga e Tij. Kjo është ajo që ju porositi Ai për t’u ruajtur nga të këqijat.”

(En’am, 153)





Kur i Dërguari i Allahut ﷺ, tha “do të veproj kështu”, e ktheu shikimin në një drejtim tjetër nga ata dhe këtë e përsëriti dy herë. (Ibn Is’hak, III, 128; Ja’kubi, II, 27)

Xhabiri رضي الله عنه, e tregon kështu formën ndikuese në ligjëratat e të Dërguarit të Allahut ﷺ:

“Kur Pejgamberi ﷺ, mbante hutben, sytë i skuqeshin, zërin e ngrinte lart dhe thoshte:

“Armiqtë do t’ju sulmojnë mëngjes e mbrëmje, andaj mbrohuni!” - zemërimi i shtoej si një komandant i cili paralajmëron ushtrinë e tij dhe duke bashkuar gishtin tregues me gishtin e mesit shtonte: “*Jam dërguar si pejgamber atëherë kur largësia në mes meje dhe Kiametit është afruar sa distanca në mes të këtyre dy gishtave.*” (Muslim, Xhuma 43; Ibn Maxhe, Mukaddime 7)

Pejgamberi ﷺ, gjithashtu ka thënë:

“*Ai që e mbron dhe kujdeset për jetimin, do të jetë në Xhenet me mua si këta dy gishta.*” Dhe bashkoi dy gishtat. (Buhari, Edeb, 24)

TREGIMI ME DORË ATËHERË KUR FLITET PËR TEMA KONKRETE

Kjo është një metodë e prerë, e cila nuk lejon vend për pasiguri në shprehje.

Kështu që diçka edhe tregohet, por edhe bëhet e mundur që të shikohet me sy.

J Dërguari i Allahut ﷺ, thoshte: “Jam dërguar si pejgamber atëherë kur largësia në mes meje dhe Kiametit është afruar sa distanca në mes të këtyre dy gishtave.”

(Muslim, Xhuma 43; Ibn Maxhe, Mukaddime 7)





Me këtë formë realizohet më mirë pranimi me anë të zemrës, por edhe kuptimi më i lehtë i çështjes në fjalë.

Aliu , tregon kështu:

I Dërguari i Allahut , mori në dorën e majtë mëndafsh, ndërsa në dorën e djathtë flori. Pastaj i ngriti duart e tij dhe tha:

“Këta të dy janë haram për meshkujt e ymetit tim, ndërsa për gratë janë hallall (të lejuar).” (Ibn Maxhe, Libas, 19; Ebu Davud, Libas, 11)

U munduam që të përmbledhim disa nga hadithet verbale të të Nderuarit të Botës, Pejgamberit , në lidhje me metodat e tij edukative. Morali i tij i ndritur, i ngjan një oqeani. Ndërsa ne mund të marrim dhe të paraqesim nga ky oqean jo më shumë se sasia në raport me perceptimit tonë logjik.

Lum ata të cilët mësojnë dhe praktikojnë këto cilësi të ndritshme të Pejgamberit !...

Zoti ynë na bëftë prej atyre njerëzve të cilët e përdorin në formën më të hajrit, mirësinë e komunikimit gjuhësor.

Na mundësoftë që etikën e komunikimit ta mësojmë prej Kuranit Famëlartë dhe prej Pejgamberit , si dhe ta praktikojmë atë në formën më të bukur.

“Besimtari për besimtarin është si pjesët e ndërtesës të cilat mbajnë njëra-tjetrën.”

(Buhari, Medhalim, 5.)





Na e bëftë gjuhën tonë si trëndafilat e Xhenetit,
që përhapin aromë të këndshme.

Na ruajttë gjuhën prej gjembave thumbues për
vëllezërit tanë.

Amin!..



Enesi ۞ tregon kështu:

*Kur po ndërronte jetë i Dërguari i Allahut ۞,
ndodheshim pranë tij. Ai na tha tri herë;
"Kijeni frikë Allahun në çështjen e namazit!"*





Përmbajtja

PARATHËNIE	5	SHPJEGIMI I NDARË NË PIKA	32
		NË FILLIM NJË HYRJE E THJESHTË PASTAJ SHPJEGIM NË DETAJE	34
		BASHKËBISEDIMI DHE METODAT E PYETJE-PËRGJIGJEVE	36
		NXITJA E NXËNËSVE PËR TË BËRË PYETJE ME QËLLIM DISKUTIMI DHE DIALOGIMI	41
		FORMIMI I PYETJEVE ME QËLLIM NXITJEN E NXËNËSIT	41
		PROVIMI ME ANË TË PYETJEVE	42
		PYETJET QË SYNOJNË ZHVILLIMIN E INTELIGJENCËS DHE MATJEN E NIVELIT TË LOGJIKËS	45
		RREGULLAT E DHËNIES SË PËRGJIGJEVE	47
		KUR PËRGJIGJJA I LIHET NXËNËSIT	47
		PËRGJIGJJA E PYETJES ME "AS MË PAS E AS MË SHUMË" POR E PLOTË DHE E PËRMBLEDHUR	50
		PËRGJIGJJA SIPAS NEVOJËS SË PYETËSIT	51
		PËRGJIGJET JO SIPAS DËSHIRËS SË PYETËSIT POR SIPAS NEVOJËS SË TIJ	52
		METODA E PËRSËRITJES	55
		PËRSËRITJA E FJALËS TRI OSE MË SHUMË HERË	56
		SHPJEGIM MBRESLËNËS ME ANË TË SHEMBUJVE DHE KRAHASIMEVE	58
		PËRFORCIMI ME BETIM	62
		SHPJEGIMI ME FORMA TË NDRYSHME	64
		PËRDORIMI I GJESTEVE DHE MIMIKËS	66
		TREGIMI ME DORË ATËHERË KUR FLITET PËR TEMA KONKRETE	67
PARATHËNIE	5		



Metodat edukuese të Pejgamberit GJUHA E TIJ EDUKUESE

RËNDËSIA E MORALIT TË FJALËS	9
"قَوْلًا سَدِيدًا" / KAVLEN SEDIDA"	10
"وَقُولُوا لِلنَّاسِ حُسْنًا" / KAVLI AHSEN"	10
"قَوْلًا لَيِّنًا" / KAVLI LEJ-JIN"	11
"قَوْلًا بَلِيغًا" / KAVLI BELİĞ"	13
"قَوْلًا كَرِيمًا" / KAVLI KERIM"	13
"قَوْلًا مَيْسُورًا" / KAVLI MEJSURA"	14
"قَوْلًا مَعْرُوفًا" / KAVLI MA'RUF"	14
E VËRTETA	17
TOLERANCA	19
RESPEKTI	21
NJË HYRJE E SJELLSHME NË TEMAT KU SYNOHET TË ARRIHET GJATË PROCESIT EDUKATIV	23
METODAT E SHPJEGIMIT	27
TRANSMETIMI I NGJARJEVE DHE NDODHIVE NË LIDHJE ME NJERËZIT MË PËRPARA	27
EDUKIMI ME ANË TË HUMORIT	30

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Topbas, Osman Nûri

Gjuha e tij edukuese / Osman Nuri Topbash;
përkth. Luan Afmataj; red. ZijaVukaj, Alban Kali.

Shkodër: Progresi, 2016

72 f.; 10.5 x 20 cm.

Tit. origj.: Onun Egitim Lisani

ISBN 978-9928-207-18-0

1. Feja islame 2. Edukimi Fetar

28 -47